



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
TË MBAJTUR MË 7.12.2016**

**DHJETOR
2016**

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Komisioni për Legjislacion, z. Albulena Haxhiu

KRYETARJA: Të nderuar anëtarë të Komisionit për Legjislacion,
E nderuara përfaqësuese e Ambasadës Amerikane,
I nderuari drejtor i Agjencionit Kundër Korrupsionit,
Të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile,
Të nderuar media, gazetarë,
Të nderuar të pranishëm,
Ju faleminderit që keni gjetur kohën dhe mundësinë për të ardhur në këtë dëgjim publik, të organizuar nga Komisioni për Legjislacion.

Më lejonit që të ju informoj se në mbledhjen e fundit të Komisionit për Legjislacion me kërkesë të disa organizatave të shoqërisë civile që është Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Organizata Qohu, Demokracia Plus, Instituti GAP dhe KDI-ja dhe në kuadër të javës kundër korrupsionit që është mbështetur po ashtu nga Ambasada Amerikane kemi vendosur që të mbajmë këtë dëgjim publik ku atë ditë jemi dakorduar për të ftuar ministren e Drejtësisë në Komisionin për Legjislacion, zonjën Dhurata Hoxha por po ashtu edhe drejtorin e Agjencionit Kundër Korrupsionit zotin Shaip Havolli.

Vetëm për hir të transparencës për shkak se sa po hyra në këtë mbledhje u pyeta nga mediat në lidhje me mungesën e ministres së Drejtësisë.

Më lejonit të ju informoj që ftesa për dëgjim publik është shpërndarë më 1 dhjetor që besoj është kohë e mjaftueshme për ta paraparë në agjendë kushdo që ka interes që të jetë i pranishëm. Tek dje janë njoftuar nga Zyra e ministres së Drejtësisë që e njëjta për shkak të agjendës së ngjeshur në kuadër të javës kundër korrupsionit nuk mund të vije në këtë Komision.

Më duhet të them që kjo nuk qëndron për faktin se ky dëgjim publik që sot po e bëjmë është në kuadër të javës ndër korrupsionit dhe me sa e di unë nuk mund të ketë dy aktivitete në të njëjtën kohë, për atë arsye po them që nuk qëndron.

Dhe me këtë rast unë po shprehë shqetësimet e mia për qasjen jo serioze dhe të papërgjegjshme të ministres karshi Komisionit për shkak se me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ministrat e kanë për obligim që t'i përgjigjen Kuvendit dhe asnjë agjend tjetër që mund ta ketë paraparë zonja ministre nuk është më e rëndësishme se sa raportimi në Kuvendin e republikës së Kosovës.

Në qoftë se e njëjta nuk mund ta bëjë punën e saj siç duhet atëherë është më mirë që ta liroj këtë pozitë që mbanë.

Megjithatë unë po vazhdoj, me që kemi sot drejtorin e Agjencionit Kundër Korrupsionit këtu, po vazhdoj për të diskutuar për çështjen për të cilën edhe e kemi thirrur këtë mbledhje.

Së pari do t'i parashtroj disa pyetje për drejtorin e Agjencionit Kundër Korrupsionit, pastaj do t'ia japim mundësin një fjalë përshëndetëse përfaqësueses së Ambasadës Amerikane, e po ashtu do ta kenë mundësinë edhe deputetët, anëtarët e Komisionit dhe përfaqësuesit e shoqërive civile që ta thonë fjalën e tyre në këtë drejtim.

Së pari më duhet me thanë që pavarësisht deklaratave publike, Kosova po vazhdon të jetë në top-listën e vendeve më të korruptuara dhe pavarësisht kësaj ne po ashtu po vuajmë nga prokurorë dhe gjyqtarë të cilët e luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Deri më tani janë krijuar shumë institucione që kinse për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, mirëpo deri më tani përfshirë edhe Agjencionin Kundër Korrupsionit më duhet me thanë që ka dështua që ta kryej mandatin me sukses.

Me që jemi këtu po i parashtroj disa pyetje në lidhje me Agjencionin Kundër Korrupsionit.

Dakord. Atëherë anëtarët e Komisionit po kërkojnë që me ja japë fjalën një herë drejtorit të Agjencionit Kundër Korrupsionit, mirëpo me që përfaqësuesja e Ambasadës Amerikane ka vetëm fjalë përshëndetëse unë po ja kaloj fjalën, nëse nuk prish punë zoti Havolli dhe pastaj kalojmë te zoti Havolli.

PËRFAQËSUESJA E AMBASADËS AMERIKANE, JEAN PHILLIPSON:
Faleminderit shumë!

Është kënaqësi që jam këtu sot me ju, po unë do të flas në anglisht, më falni.

JEAN PHILLIPSON: Është kënaqësi të jem këtu për të përkrahur punën e Komisionit të Kuvendit dhe partnereve tanë të OJQ-ve, GLPS, Çohu dhe KDI, në luftën kundër korrupsionit në Kosovë.

Siç ka thënë ambasadori Delawie, “lufta kundër korrupsionit kërkon përfshirje nga tërë qeveria dhe tërë shoqëria”, prandaj jam shumë i kënaqur të shoh se legjislatura dhe shoqëria civile janë bashkuar për të gjetur zgjidhje në këtë luftë kundër korrupsionit.

Tema e juaj sot është veçanërisht e rëndësishme, pasi që në gjithashtu besojmë se Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kundër Korrupsionit duhet të kenë një rol të rëndësishëm në këtë çështje.

Ambasada e jonë, përmes OPDAT programit të Departamentit të Drejtësisë dhe USAID-it, është fuqishëm e përkushtuar për të bërë përpjekje të përmirësohet korniza ligjore e Kosovës për efikasitetin gjyqësor dhe pavarësinë, si dhe përpjekjeve për të përmirësuar kapacitetin brenda sektorit të drejtësisë.

Gjithashtu, e kemi kënaqësinë t’i ofrojmë përkrahje draft ligjit të Ministrisë së Drejtësisë për të përforcuar kapacitetin e Zyrës të Prokurorit Disiplinor, i cili do të publikohet për komente këtë të premte. Ky draft ligj është një mënyrë për ti mbajtur prokuroret dhe gjyqtaret përgjegjës për shpërdorim, kjo posaçërisht është e rëndësishme në rastet e korrupsionit.

Ne e mirëpresim iniciativën nga Ministri Hoxha pas vendimit të Qeverisë të Kosovës me datën 22 Nëntor, për një shqyrtim funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Qëllimi është të identifikohen dhe definojnë objektivat strategjike të sundimit të ligjit për të rritur efikasitetin e institucioneve shtetërore në zbatimin e ligjit dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse të sundimit të ligjit. Ne kuptojmë se ky projekt do të fokusohet kryesisht në përforcimin e institucioneve kundër korrupsionit, duke e përmirësuar bashkëpunimin dhe koordinimin në mes të tyre.

Një progres pozitiv është shënuar në ngritjen e profesionalizmit dhe efikasitetit të sektorit të drejtësisë. Fatkeqësisht, sondazhet tregojnë që qytetaret e Kosovës ende nuk besojnë në drejtësinë e gjyqtarit.

Për këtë arsye, diskutimet siç është ky janë shumë të rëndësishme, por veprimet tona janë edhe më të rëndësishme.

Nuk mjafton vetëm të bisedojmë, siç tha edhe ambasadori Delawie, ne duhet vazhdimisht të punojmë në këtë drejtim dhe duhet të kërkojmë veprime. Lufta kundër korrupsionit është shumë e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARJA: Faleminderit, shumë!

Zoti Havolli, fjala është për ju.

SHAIP HAVOLLI: E nderuara kryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete,

Të nderuar anëtarë të Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete,

Të nderuar përfaqësues të Organizatave të shoqërisë civile dhe mediat,
Të nderuar të pranishëm,
Java kundër korrupsionit e gjen Agjencinë Kundër Korrupsionit me angazhimet e saja në kuadër të misionit dhe kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Në pika të shkurta do të prezantoj një raport lidhur me punën e Agjencionit Kundër Korrupsion për vitin 2016 edhe pse raportet e sakta dhe shifrat do t'i merrni kur do të publikohet raporti vjetor i Agjencisë.

Në fushën .. janë trajtuar diku rreth 200 raste të dyshuara për korrupsion qoftë të raportuara dhe qoftë të iniciuara sipas detyrës zyrtare nga zyrtarët e Agjencionit Kundër Korrupsionit.

Gjatë hetimit të këtyre rasteve, në disa raste ka pasur edhe .. të veprave penale dhe janë lëshua kallëzime penale të cilat kallëzime penale janë dërgua në prokuritë kompetente.

E po ashtu ka edhe raste që janë identifikuar si shkelje administrative të cilat janë iniciuar për fillimin e kërkesës për procedurë disiplinore.

Po ashtu ka disa raste që Agjencia në mungesë të kompetencave policore i ka dorëzua disa raste për trajtim të mëtejshëm në Policinë e Kosovës dhe në prokuritë themelore dhe në Prokuri Speciale.

Në fushën e deklarimit të pasurisë siç e dinë janë në proces të kontrollit të 20% të zyrtarëve të cilat janë përzgjedh për kontroll të rregullt.

Deri më tash janë gati në përfundim të kontrollit, ndërsa në raportin vjetor do të dalim me konkluzione dhe detaje lidhur me çështjen e këtij kontrolli rreth deklarimit të pasurisë.

Po ashtu sa i përket konfliktit të interesit, Agjencioni deri më tash ka trajtuar mbi 150 raste të konfliktit të interesit, ku 100 prej këtyre rasteve janë shmangur, janë nxjerr edhe 32 opinione dhe po ashtu presim që të penalizohen ata që nuk e kanë zbatuar këto rekomandime që kanë dal nga agjencioni.

Në fushën e prokurimit që kjo fushë vazhdimisht është problematike.

Agjencia deri më tash ka monitoruar mbi 90 aktivitete të prokurimit publik ku janë dhënë opinione në lidhje me këto aktivitete të prokurimit ku shumicën prej tyre opinioneve autoritetet kontraktuese edhe kanë zbatua.

Domethënë të gjitha këto aktivitete lidhen me shkelje të ligjit të prokurimit e po ashtu në lidhje me shkele të Ligjit të prokurimit agjencia ka bërë edhe disa kallëzime penale, thash që këto do t'i keni informacionet kur bëhet raporti i përgjithshëm lidhur me këto detaje.

Sa i përket edukimit po ashtu Agjensioni Kundër Korrupsionit ka vazhduar me aktivitetet e edukimit në fusha të ndryshme, në fushën e edukimit të publikut, nxënësve, studentëve dhe zyrtarëve.

Sa i përket strategjisë siç e dini, Agjensioni ... me strategjinë ka bërë raport për 6 mujorin, ka ngecje sa i përket raportimit të strategjisë nga institucione të ndryshme. Edhe po ashtu do të filloj përgatitjet për vitin e ardhshëm që do të bëhet strategjia e re kundër korrupsionit.

Sa i përket mediave dhe shoqërisë civile Agjensioni ka pas disa takime me media dhe shoqërinë civile duke përkrahë edhe nga GDP që e falënderojmë, ku mediat dhe shoqërinë civile ne e konsiderojmë si partner të përbashkët në luftën kundër korrupsionit.

Disa raste të publikuar në media dhe disa raste të pranuara dhe nga shoqëria civile agjensioni veç ka fillua me i trajtua dhe ka pasur rezultate.

Po ashtu agjensioni është pjesë edhe e zbatimit të MSA-së të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe raportit të progresit ku jemi duke plotësua disa kriterë që janë në domen e agjencisë.

E po ashtu në kuadër të projektit PEK dhe mendimet edhe të GDP-së dhe institucionet edhe të Ministrisë të Drejtësisë kemi draftua Ligjin për konflikt interesi dhe po ashtu jemi duke bërë përpjekje që në vitin që vjen të draftohet Ligji për agjencinë dhe Ligji mbi deklarin e .. dhe pasurisë.

Këto janë disa prej temave që Agjencioni Kundër Korrupsionit i ka bërë gjatë këtij viti. Kështu që besoj se jam i hapur për pyetje. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Havolli!

Nuk e di nëse janë dakord anëtarët e Komisionit që me ja japë fjalën shoqërisë civile pastaj ne apo.

FISNIK KORENICA: A bënë një propozim me bë?

KRYETARJA: Po Fisnik,

FISNIK KORENICA: Unë propozoj Komisionit që me vazhdua ...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARJA: Atëherë po besoj që nuk ka asnjë problem që të vazhdojmë me diskutimet e deputetëve.

Në fakt unë prita që të kemi të dhëna më të detajuara sa i përket punës së Agjensionit Kundër Korrupsionit.

Megjithatë po e shfrytëzoj rastin që t'i parashtroj disa pyetje.

Së pari, deri më tani kemi dëgjuar deklarata publike që prokuroria po i hedh poshtë kallëzimet penale të Agjencionit Kundër Korrupsionit. Në qoftë se keni mundësi me na njoftua se sa jeni të kënaqur me punën e prokurorisë.

Dhe në qoftë se nuk jeni të kënaqur pse asnjëherë si drejtor i ri i Agjensionit Kundër Korrupsionit nuk e keni adresuar publikisht për shkak se këtë e kemi dëgjuar nga zoti Preteni si ish drejtor i Agjensionit Kundër Korrupsionit dhe a ka ndryshuar qasja e prokurorisë në raport me kallëzimet penale që bënë nga Agjensioni Kundër Korrupsionit. A është matur ndonjëherë efikasiteti i Agjensionit Kundër Korrupsionit në arritjen e qëllimeve në linjë me mandatin e saj. Sa i përket besimit të qytetarëve tashmë ekziston një mosbesim i qytetarëve karshi jo vetëm Agjensisë Kundër Korrupsionit por edhe prokurorisë e policisë dhe a e keni vlerësuar ndonjëherë besimin e qytetarëve në raport me Agjensionin Kundër Korrupsionit që e kanë ata për Agjencionin Kundër Korrupsionit. Sa prej rasteve që i keni raportua tek institucionet e sundimit të ligjit kanë rezoluta me aktgjykim dënues përfundimtar.

Ju përmendën qasjen me shoqërinë civile, unë uroj që kjo të vazhdoj për shkak se nuk kemi pasur një bashkëpunim të mirë të agjensionit me shoqërinë civile. Pra ka qenë jashtëzakonisht shumë i mbyllur që për këtë mund të flasin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Dhe sa i përket projektligjeve të cilët i përmendët çka në fakt, cili është qëllimi i ndryshimeve të këtyre ligjeve Ligjit për Agjensionin Kundër Korrupsionit që të zgjerohet në kompetenca të Agjensionit Kundër Korrupsionit apo cili është qëllimi dhe atë për deklarinimin e pasurisë.

Dhe, a mendoni që veprat e korrupsionit të natyrës korruptive duhet që të mos parashkruhen, për faktin se kemi pasur tash së fundi ku për shkak të parashkrimit janë amnistuar shumë zyrtarë dhe a mendoni që edhe veprat korruptive për shkak të rrethanave të cilat ne i kemi të mos parashkruhen.

SHAIP HAVOLLI: Faleminderit!

Sa i përket kallëzimeve penale rreth hudhjes ka qenë një debat gjith her i ashpër me ish drejtorin dhe prokurori dhe gjykatat lidhur me hudhjen e këtyre kallëzimeve penale.

Sa i përket kallëzimeve penale dhe hudhjen, unë me të marrë detyrën kam pasur një takim me kryeprokurorin e shtetit dhe është biseduar edhe çështja e hudhjeve të këtyre kallëzimeve penale.

Kryeprokurori i shtetit i ka pasur disa shqetësime të cilat i ka marrë nga prokurorët kompetent që i kanë hudh këto kallëzime penale, sepse këto kallëzime penale deri diku nuk kanë qenë të materializime mirë për arsye sepse edhe vetë agjensioni nuk ka një mandat ekzekutiv dhe s'ka mundë t'i merr të gjitha masat me rastin e ushtrimeve të kallëzimit penal, domethënë nuk ka mundë të gjitha ato prova materiale të mjaftueshme por kryesisht i ka dërgua në prokuroritë me dyshim të arsyeshëm por jo dyshim të bazuar.

Unë besoj që kjo çështje veç tash e tutje kur para se të ushtrohet kallëzimi penal unë i kam urdhëruar edhe zyrtarët që merren me hetime që paraprakisht të kontaktojnë prokurorin në rastin kur jem në atë fazë të ushtrohet kallëzim penal ose të mbyllet rasti s'ka element të veprës penale.

Kjo ishte çështja sa i përket hedhjes së kallëzimeve penale.

Sa i përket efikasitetit të agjensionit, unë mundem me thanë që Agjensioni për mandatin që ka dhe rolin që ka dhënë ka treguar efikasitet, nuk mundem me thanë që jemi të kënaqur me këtë efikasitet por megjithatë konformë mandatit që ka tregua rezultate dhe po ashtu edhe në fushën e parandalimit që këtë fushë shumë pak po e llogaritin si fushë e punës sepse në iks raste është parandalua qoftë në

formë të prokurimit, konfliktit të interesit edhe të hetimeve, që këto çështje të parandalimit dhe çështje të hetimit të rastit parandalimit ato nuk janë shumë për publikun sepse ato mbesin të mbyllura sepse nuk ka pasur elemente të penale, mirëpo është parandalua një aktivitet kriminal.

Besimi i qytetarëve, është e vërtetë që besimi i qytetarëve është i zbehur sa i përket çështjes së zbatimit të ligjit. Megjithatë, jemi të vetëdijshëm se kohëve të fundit ka progres sa i përket zbatimit të ligjit duke u bazuar në raportet e prokurorive dhe gjykatave dhe të agjencionit e të policisë ka një progres. A jemi të kënaqur me këtë progres, nuk jemi. Mirëpo ka disa aktakuza që shpresojmë që këto aktakuza të mos vinë deri te parashikimi por këto të penalizohen dhe të sillin dënime të merituar.

Sa i përket rasteve të agjencionit, cili është statusi i tyre. Bazuar informacionet unë që i kam nga prokuroria themelore dhe nga prokuroria speciale, janë disa raste të mëdha dhe aty është ngritë edhe aktakuza. Mirëpo nuk është e Agjencionit të bëjë publike kush janë persona dhe cilat janë rastet të cilat i ngrit aktakuza. Domethënë ka progres edhe pse një numër mjaftë i tyre kallëzim penal është hüdë, mirëpo megjithatë janë disa raste që janë për të falënderuar edhe agjencinë edhe prokurorinë e shtetit.

Sa i përket ndërrimit të ligjeve. Është parë nevoja me vetë zhvillimin edhe trendin e zhvillimeve vendore dhe ndërkombëtare në aspektin legjislativ dhe në aspektin edhe vetë krimi ka ndryshua ose ka përparua në fushën e krimit. Domethënë në krahas këtyre zhvillimeve duhet pa tjetër edhe t'i ndërrojmë edhe t'i draftojmë ligjet.

Siç e dini Ligji për konflikt interesi edhe gjatë hetimit edhe gjatë trajtimit ka pasur shumë problematika rreth sjelljeve të vendimit për konflikt interesi dhe është e domosdoshëm këtu me këtë ligj të planifikohet dhe të rregullohet edhe çështja e disa punësimeve brenda vetë institucioneve të Qeverisë që besoj që do të kalonë.

E po ashtu janë edhe disa kërkesa, agjencioni të ketë një fuqi pakë më shumë në fushën e parandalimit në fushën e prokurimit.

Te çështja e deklarimit të pasurisë, kemi vërejt se ka problem rreth deklarimit sidomos rreth formularit, po ashtu ka problem rreth deklarimeve të pasurisë rreth prejardhjes, po ashtu edhe rreth çështjeve të ... plotësimit të formularit ka shumë paqartësi rreth ... domethënë o vlera e paragjykuar, o vlera me kontrata, te kontrata mbi falje, domethënë ka probleme të natyrës së ndryshme sa i përket kësaj çështje.

Edhe po ashtu agjencioni e trajton këtë çështje po nuk ka edhe mjaft kompetenca sa i përket me të vërtetë ta verifikon lidhur me prejardhjen e pasurisë. Kështu që edhe këtu do të ketë nevojë për një ridraftim të këtij ligji.

Sa i përket shoqërisë civile, thashë me të marrë detyrën një prej rekomandimeve ka qenë edhe nga vetë ana e Komisionit po edhe ka qenë edhe ide e imja që me shoqërinë civile të takohemi, të dakordohemi sepse edhe këta i shohim si pjesë e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit edhe apsolutikisht nuk më pengon asgjë të kem takime edhe bashkërisht të rrugëtojmë sa i përket kësaj rruge për luftim dhe parandalim.

Mirëpo kemi kërkuar të njëjtën anë që të jemi real në vlerësimet nëse ka vlerësim pozitiv të jetë ai pozitiv.

Kjo është në pika të shkurta sa i përket, nëse nuk e kam harrua ndonjë pyetje tjetër. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Havolli!

Po kalojmë te anëtarët e Komisionit për Legjislacion, zonja Halimi pastaj zoti Zemaj, pastaj zoti Aliju, pastaj zoti Lekaj.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit!

Përshëndetje për përfaqësuesin e Ambasadës zonjën Jean që është sot këtu, Një herrit edhe falënderim për përkrahjen dhe kontributin e vazhdueshëm që erdhën gjithë sektorët në veçanti në një fushë që tashmë është bërë mjaftë e ndishme në Kosovë për luftën kundër korrupsionit.

Përshëndetje për drejtorin e Agjencisë,

Dhe gjithë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që mjaftë po kontribuojnë në sfera të ndryshme dhe jeni duke na ndihmuar edhe neve si Komision, Faleminderit!

Unë do të përqendrohem në atë që ne sot jemi në një javë faktikisht është java e luftës kundër korrupsionit që nënkuptoj si një lloj mobilizimi të gjitha institucioneve për të bërë hapa konkretë secili në sajë të kompetencave të veta për të parandaluar gjegjësisht për të luftuar korrupsionin.

Me qenë se e shoh kësi soji dhe tema e takimit ka qenë të arritjet sfida dhe avancimi në luftën e korrupsionit unë nuk do të orientohej në pyetje rreth agjencionit apo institucioneve tjera, por do të ndalem në faktin se çfarë ndodhi me Kosovën që për 16 vite që arritëm në pedestal të korrupsionit.

Cilat janë sfidat që sot ne ballafaqohemi për të luftuar korrupsionin dhe a kemi bërë ndonjë hap avancimi drejtë këtij qëllimi.

Korrupsioni zë fill të diskutohet me të madhe dhe madje po thuaj se edhe në çdo familje në Kosovë jo vetëm në institucione dhe në media, jo vetëm në grupe të organizuara, se institucionet, shoqëria kosovare është e korruptuar qofshin ata që kryejnë shërbime për publikun, qofshin ata që kërkojnë shërbime nga institucionet dhe kjo është vërtetë e dhimbshme.

Korrupsioni nuk lindi për një natë as për një ditë. Secili prej nesh duhet të shtroj pyetjen se pse para 15 viteve, para 13 viteve edhe para 14 viteve, para 10 viteve nuk u parandalua, nuk u ra në kokë të njerëzve që u korruptuan por u hesht nga institucionet përkatëse që kishin për detyrë të luftojnë korrupsionin dhe tashmë kemi ardhur në një pikë që secili e sheh veten e sheh tjetrin afër vetes cili është më i korruptuar. Kjo për dhimbje si shoqëri.

Kur e them këtë kam parasysh faktin që a i interesoj dikujt që Kosova pas 16 viteve çlirim të cilësohet si vendi më i korruptuar në rajon dhe nëse po, kujt i interesoj dhe kush i mbështeti nga vendorët këtë ide. Fundja për të ekzistuar një shoqëri jo e korruptuar, për të qenë secili në krye të detyrës konform kompetencave që ai e autorizon ligji është obligim i yni dhe këto detyra janë tona dhe kemi obligim ne t'i kryejmë vetë.

Mirëpo, një dezorientim në këtë fushë nuk ja kemi pas borxh askujt, në veçanti institucioneve të cilat kanë pasur përgjegjësinë që nga paslufta e deri para tri viteve që të luftojnë korrupsionin të parandalojnë korrupsionin.

Dua të bëjë një krahasim mes luftës kundër radikalizmit dhe ekstremizmit në Kosovë me luftën kundër korrupsionit.

Për tri vite Kosova arriti të cilësohet si vendi më i suksesshëm qoftë në hartimin e legjislacionit, qoftë në hartimin e strategjive në parandalimin e veprimit të grupeve ekstremiste dhe radikaliste në Kosovë. Këto nuk janë deklaratatë të mijat personale por janë hulumtime të bëra nga organizata kompetente qofshin vendore dhe ndërkombëtare dhe rezultatet janë të dukshme të prekshme.

Po sikur t'i kishim kompetencat edhe më herët ne për të luftuar korrupsionin jam e bindur që do të ishim po kaq të suksesshëm.

Për 16 vite, faktikisht hiqi tri të fundit për 13 vite nuk patëm kompetenca dhe korrupsioni arriti të lulëzoj tri vite na u dashtë që të sensibilizohen gjithë mekanizmat për të luftuar korrupsionin.

Një krahasim i tillë çfarë e bëra sot jo për të adresuar përgjegjësi te dikush tjetër, por për të kërkuar llogari në pengesa të vazhdueshme që ende bëhen për t'u bërë lufta kundër korrupsionit suksesshme, pikërisht nga ata që patën kompetenca për 13 vite me radhë në Kosovë në sektorin e drejtësisë.

Çështja e sfidave: Sfidat janë, mirëpo ne nuk kemi një hulumtim një matëshmëri përjashtim atij konkret të dukshëm se sa institucionalist, sa persona janë të korruptuar që dyshohet që unë e kam korruptuar dikë apo dikush mua. Por kemi vetëm hulumtim të perceptimit dhe kemi hulumtim të tenderamanisë.

Mungesa e punësimit dhe mundësia e punësimit të një kategorie të caktuar le bazë për krijimin e opinionit se ka korrupsion.

Ngarkimi i kategorive të caktuara të njerëzve me shumë përgjegjësi le bazë për korrupsion apo për të dyshuar se ka korrupsion.

Matja e korrupsionit unë mendoj që duhet të bëhet me mjet konkret, sa u akuzuan, sa u dënuan, atëherë mund të themi se ka korrupsion apo nuk ka. Se vetëm ideja se unë nuk arrij të punësohem për 10 vite me diplomë apo vetëm ideja se tjetri bëri një pasuri pa u faktuar nuk guxojmë ta krijojmë atë opinionin që çdo gjë në Kosovë është e korruptuar sepse kemi një shtresë tepër të ndershme dhe tepër me përgjegjësi që është duke punuar në institucione pavarësisht niveleve.

Nëse 3-4 janë të korruptuar në një institucion nuk mund të shohim komplet institucionin e korruptuar, por duhet analizuar edhe anën tjetër. Pse njerëzit kanë frik të deklarojnë për njerëz që janë rreth tyre të korruptuar, apo për të cilët mund të faktojnë.

Frika është se çdo gjë që ngritët për të shkuar marrë në vend të nesërmen nuk e njeh veten nga reagimet po të kësaj shoqërie që kërkon luftimin e korrupsionit.

Do të thotë ne duhet të ndajmë nëse vërtetë jemi sensibilizua dhe duam që të luftojmë korrupsionin dhe jo vetëm këtë por edhe dukuri tjera se para se me ardhur deri te korrupsioni janë një varg veprash që po ashtu janë penale të cilat e shtynë njërin të bëhet i korruptuar.

Edhe me këtë nuk jemi duke u marrë, jemi duke u marrë vetëm me të fundit, marrje dhënie jo.

Unë mendoj që këto janë ato sfidat, pse njerëzit hezitojnë të deklarojnë për personin që është i korruptuar.

Nëse unë i përgjigjem një pyetësi të një organizate joqeveritare, po ka korrupsion në Kosovë, pyetësor anonim qysh bëhen hulumtimet krejt në rregull. Pse unë kam frikën të deklaroj dikund në institucione që do të merren me hulumtime të mëtejshëm se ka korrupsion.

Besoni që nuk është frika gjithherë prej atij të cilin e deklaroi personi, po frika është komplet nga zinxhiri qoftë ai i organizuar në institucione qoftë ai i organizuar në organizata joqeveritare, sepse mendoj që ende nuk e kemi arrit po them mendimet e mijë se bukur shumë jam t'u hulumtua, ende nuk e kemi arrit atë pjekurinë që vërtetë duhet të luftohet një dukuri negative.

Avancimi. Në kuadër të avancimit unë vetë faktin që të gjitha institucionet janë sensibilizuar për këtë çështje e shoh që jemi avancua. Por, na duhet që gjatë kësaj jave secili grupacion qoftë edhe ne si Komision qoftë edhe institucionet tjera po pres shumë prej organizatave joqeveritare të dalim me disa rekomandime në kuptimin e diskutimeve që kanë dal dhe çka duhet të bëjnë institucionet si dhe rishikimi komplet i legjislacionit është domosdoshmëri.

Duhet të mendojmë a kanë nevojë njerëzit tanë në institucionet tona që të kenë një kod apo një udhëzues shumë të qartë shumë real për çdo gjë që mund të qoj në një vepër korruptive edhe të ju afrojmë atë.

Fundja, parandalimi është shumë i lehtë, është shumë më pak i kushtueshëm dhe shoqëria nuk do të vuaj gjatë. Po që se i japim prioritet vetëm pasojave nga pasojat ose t'i sanojmë pasojat janë shumë më të kushtueshme, shumë më të dëmshme për shoqërinë në qoftë se një i korruptuar gjithsesi se duhet ta marrë dënimin e merituar por sa do t'i vuaj familja nesër pse i ka qëllua ta këtë babë, a vëlla, a motër një person që është korruptuar lehtë do të thotë mendoj që duhet të ndalemi më së tepërmi te parandalimi.

Këta që janë të korruptuar gjithsesi të ndiqen, por të merremi me parandalim dhe të hiqet nga mendja e shoqërisë në Kosovë se në Kosovë mjafton të jesh në komunë, në Qeveri apo në Kuvend dhe t'i mund të bësh çka të duash.

Po elemente korruptive ka edhe po qe se unë e kërkoj një shërim edhe nuk pres në rend me krye, s'ka nevojë me më privilegjua mua shoqëria pse unë jam deputet në fund të fundit, sepse me momentin që mua më privilegjon ia dëmton interesin sepse ja humb kohën një tjetrit që e kërkon të njëjtin shërbim.

E mora këtë vetëm shembull me e plotësua atë që thash ka shumë çështje apo shumë veprime derisa të vjen te ajo veprimi i fundit që mund të quhet korrupsion.

Nuk do të vazhdoj më gjatë mirëpo është koha që të gjithë së bashku të bëjmë diçka konkrete edhe unë besoj që ja dalim ta bëjmë këtë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Halimi.

Është mirë që ta shfrytëzojmë këtë dëgjim publik si dëgjim ku i dëgjojmë palët më shumë. po ja kaloj fjalën zotit Zemaj, pastaj zoti Aliu dhe zoti Lekaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Përsëendetje për të gjithë,

Kolegë deputetë, drejtorinë,

Përfaqësues të shoqërisë civile,

Përfaqësues nga Ambasada Amerikane,

Ju media të nderuar dhe të gjithë opinionit të cilët jo rrallë herë apo tema të tilla ndoshta nuk do t'i quaj që janë atraktive por shprehin interesim të veçantë në raport edhe me qëndrimet politike por edhe me rritjen e efikasitetit permanent në luftën kundër korrupsionit.

Unë do të theksoja që jo vetëm java e shpallur kundër korrupsion por besoj që çdo ditë apo ta quaj në vende siç është edhe Kosova pjesë e tranzicionit çdo orë është e nevojshme që të kemi veprime konkrete në parandalimin qoftë, por edhe luftimin e kësaj dukurie negative, se a ka korrupsion në Kosovë kjo më nuk është temë tabu. Unë duhet të merremi se cilat janë veprimet që ta luftojnë korrupsionin, mbi të gjitha njerëzit e korruptuar apo edhe zinxhirin e korrupsionit të qon edhe tek krimi i organizuar në Republikën e Kosovës.

Ajo çka i takon takimeve të tilla është mendim i imi se përpos pjesës së sensibilizimit ta quaj kështu kushtimisht edhe deklaratave që janë edhe qoftë për opinionin publik, por edhe deklaratat të cilat merren parasysh nga institucionet përkatëse. Mendoj që hapat konkret duhet të jenë më të radikalizuar ta quaj kushtimisht për të arritur qëllimin e përbashkët aty ku dëshirojmë të arrijmë.

Se si bëhet kjo, kjo bëhet pikë së pari me njerëzit që janë të pastër dhe nuk kanë afëra korruptive, mbi të gjitha edhe e kaluara e tyre të shpresë, mundësi dhe hapësirë që njerëzit në pozita të caktuara në pozicione të caktuara mund të përballen me luftën kundër korrupsionit, kjo është e para. Dhe, e dyta ajo çka shohim ne nuk kemi na mungon ajo hallka kryesore apo zinxhiri kryesor është dënimet efektive që është finalja e të gjithë kësaj pune që bëhet në luftën kundër korrupsionit.

E dëgjuam edhe drejtorin e Agjencisë e kemi dëgjuar edhe në të kaluarën, po e shohim edhe tash pothuajse Kosovën është duke e përcjell problemi i njëjtë. Ka hetime, ka tendencë për parandalim, prokuroria e kryen deri diku punën e vetë, por në fund të fundit edhe verdiktet e fundit janë shumë mbresëlënëse apo të rikthyera në fazën zero kur shumica e njerëzve që pothuajse janë përballë edhe me afëra korruptive jo rrallëherë kthehen në të njëjtat pozicione edhe në institucionet publike. Shembujt këta i dinë më mirë edhe shoqëria civile, shembujt kanë qenë publik, janë apostrofuar edhe nga deputetët në mënyrë individuale.

Por, sido që të jetë besoj që kjo javë, këto organizime të jenë vetëdijesim i plotë i të gjithë atyre që me të vërtetë dëshirojnë që ne të kemi një vend ku korrupsioni jo duhet të jetë në shkallën minimale por, i luftuar deri në maksimumin e nevojshëm. Besoj që legjislacioni nuk është pengesë për luftimin e korrupsionit, këtë e them nga përvoja ime personale. Ne kemi një legjislacion adekuat. Mund të kemi përmirësime në veprimet të vogla, të cilat ndoshta do të duhet të rritin efikasitetin, por jo që të paraqitet legjislacioni si pengesë në luftimin e krimit dhe korrupsionit në vend. Dhe, kjo mund të marrim edhe shembuj konkret se pse Kosova ka legjislacion më të avancuar ndoshta që vendet tjera, por gjithmonë mbetet avancimi po mbetet sfida, arritjet po mbeten sfida dhe këto duhet të eliminohen.

I takon Kuvendit të Kosovës që takimet tilla të organizojë më shumë, jo vetëm në javën kundër korrupsionit i takon Komisionit për Legjislacion ku në kuadër të saj është edhe mbikëqyrja e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe ne të marrim opinione, por njëherësh të japim edhe rekomandime konkrete në raport kthyes për punët dhe veprimet që duhet të bëhen. Në këtë kontest edhe shoqëria civile do të kishte hapësirë, do të kishte mundësi, do të ishte më korrekte edhe në raportimin e kësaj dukurie dhe atëherë edhe raportet nuk do të quheshin perceptim, por do të quheshin luftë reale apo edhe perceptim real në atë që ne e quajmë sot korrupsion edhe institucional qoftë edhe ai administrativ apo edhe penal.

Unë besoj që pa një bashkërendim të aktiviteteve të tilla diku prapëseprapë një hallkë do të mungojë, por mbi të gjitha varet edhe nga ajo që e thashë në fillim

njerëzit me kompetencë që do ta kryejnë këtë punë dhe njerëzit që nuk janë peng i aferave të ndryshëm korruptive apo grupeve para politike, politike dhe grupeve kriminale të organizuara.

Unë besoj që kjo mund të arrihet ka njerëz Kosova, ka kapacitete të tilla, shpresoj shumë që edhe Agjencia Kundër Korrupsion tash në këtë fazë edhe të paraqitjes edhe të pjesë të raportimit do ta kryejë punën e vetë, por mbi të gjitha ne kemi nevojë që ta ngritim zërin bashkarish në rritjen e efikasitetit të gjyqësorit në Republikën e Kosovës. Aty është poenta kryesore, pa një gjyqësor të fortë, pa një prokurori të fortë, pa një polici e cila e bën punën e vetë në mënyrë të pavarur dhe me efikasitet të shtuar ne nuk do të arrijmë qëllimin e caktuar. Mund të vijë shembuj të vendeve të rajonit, sepse ne çdo ditë flasim për integritime evropiane dhe askush në familjen evropiane nuk do ta pranojë një Kosovë të tillë çfarë është në një shkallë të lartë të nivelit të korrupsionit apo edhe pjesëve tjera integritimeve euro atlantike.

Kështu që unë i quaj sfiduese nuk i quaj të pamundshme, të paarritura këto besoj që nuk do të mbesin tema vetëm si pjesë e javës kundër korrupsionit, sepse po e përmbylli edhe me një thënie se korrupsioni është sikurse plehrat, nëse një ditë dy nuk e largojmë plehrat ajo vetëm ta zë derën e oborrit. Kështu që korrupsionin duhet ta luftojmë çdo ditë, e thashë edhe njëherë çdo orë, por mbi të gjitha me vullnet dhe me përkushtim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Aliu.

Agim ALIU: Faleminderit, zonja kryetare!
E nderuara përfaqësuese e Ambasadës Amerikane,
I nderuar drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsion,
Të nderuar përfaqësues të mediave,
Përfaqësues tjerë këtu prezentë,
Të nderuar kolegë deputetë,

Gjithsesi është e rëndësishme që ne sot jemi takuar këtu, gjithsesi është e rëndësishme që ka pasur edhe takime në kuadër të javës të luftës kundër korrupsionit edhe në forume dhe nivele tjera, por absolutisht unë jam shumë i sigurt se të gjithë dakordohemi se krejt kjo po na është e pamjaftueshme në sfidën që ne kemi jo vetëm si institucione, por edhe si shoqëri.

Është mirë që kemi këtë javë të paktën për të tërhequr vëmendjen se cila është sfida reale e Kosovës sot edhe institucioneve edhe shoqërisë. Sepse, ka kohë

Kosova që ka humbur drejtimin e saj, ka kohë që Kosova ka humbur rrugën e saj, ka kohë që Kosova ka krijuar tema, të cilat në fakt nuk do të duhej të ishin tema dhe në fakt e kemi lënë anash një temë e cila në fakt është duke e cenuar edhe të sotshmen, por është duke e cenuar mbi të gjitha të ardhmen tonë.

Prandaj, do të ishte mirë që përveç këtij aspekti formal të një organizimi të tillë të një jave vërtetë puna jonë si institucione dhe puna jonë si shoqëri të jetë e çdo ditshme në mënyrë që vërtetë ta shërojmë këtë plagë të krijuar e cila në fakt është duke dëmtuar të ardhmen e gjeneratave që po vijnë. Ne mendoj që jemi excellent në konstatimin e gjendjeve dhe kjo nuk na ka munguar gjatë gjithë kësaj kohe, ne mund ta gjuajmë topin ku të duam, por ne megjithatë duhet ta pranojmë faktin dhe fakti është se ne kemi korrupsion, kemi krim të organizuar prandaj edhe kur e kemi duhet luftuar atë.

Nuk mendoj që do të na shërbente shfajësimi i përhershëm se nuk e patëm kompetencën ta luftojmë pavarësisht që nuk po themi që edhe ata nuk janë hisedarë të krijimit të një shtate të tillë, është e sigurt edhe dinë të gjithë që sistemi i drejtësisë e ka pasur procesin e vetë që ka qenë i kritikuar në mënyrën e ndërtimit të saj dhe sigurisht që kjo ka penguar në një adresim dhe në një luftë konsistente dhe të vendosur të fenomeneve të këqija, por kjo nuk e anashkalon përgjegjësinë që ne kemi edhe dje, por sot, por mbi të gjitha edhe nesër që duhet ta kemi për të luftuar fenomenet e këqija mbi të gjitha korrupsionin.

U thanë nga parafolësit tanë, është fakt është një fatmirësi që ne kemi ligje, të cilat nuk e pamundësojnë luftën kundër korrupsionit. Por, është problemi që vërtetë nuk është luftuar. Ne këtë sistem dhe këto ligje, ky legjislacion e kemi ndërtuar dhe për këtë duhet të jemi mirënjohës edhe Bashkësisë Ndërkombëtare edhe partnerëve tjerë edhe shoqërisë civile që kanë bërë të mundur që të kemi një sistem të tillë. Po ashtu, fal edhe përkushtimit edhe Kuvendit edhe gjatë kësaj kohe jemi munduar që ne të bëjmë depolitizimin formal të institucioneve të drejtësisë. Por, asnjëherë nuk jemi marrë me atë se në fakt çfarë është duke ndodhur, mos janë krijuar sisteme brendapërbrenda mekanizmave të drejtësisë.

Është një temë e përhershme në Kosovë që mua po më duket është shndërruar në një lloj pengese, agjencione, institucione të pavarura. Por, sa në fakt ata vetë janë të pavarur, sa në fakt ata vetë janë kah i luftojnë këto veprime negative. Unë edhe në çështje të caktuara që kanë të bëjnë me ligje të caktuara kam ngrit këtë shqetësim, sepse në emër të depolitizimit dhe në emër të një krimi të një pavarësie ne në fakt jemi duke krijuar institucione, të cilat thuaja nuk japin llogari askujt.

Dhe, unë mendoj që duhet bërë një punë e madhe, një veprim i qëndrueshëm i të gjitha institucioneve përgjegjëse në këtë rast, që të shtohet ky kontroll pa e cenuar ndarjen e pushteteve në mënyrë që vërtetë të shohim rezultate konkrete prej këtyre institucioneve. E thashë më herët se ne jemi eksellentë në konstatimet e gjendjeve dhe tashmë jemi të mbushur me konstatime dhe jemi të mbushur edhe me statistika. Kemi edhe shumë spektakle, por ne nuk kemi njerëz që po vuajnë dënimet e merituar që do t'i konstatonte drejtësia për veprimet që po e themi edhe janë pjesë e perceptimit.

Është e vërtetë ne të gjithë e dimë që perceptimi nuk është fakt, por megjithatë perceptimi flet diçka pse është kjo shkallë kaq e lartë e perceptimit për fenomenet negative. Unë mendoj që duhet dal nga kjo fushë, nga ky nivel prej krijimit të spektakleve, prej krijimit të statistikave por me veprime konkrete, por gjithsesi se do të duhej të bëhej një rishikim i këtyre organeve dhe këtyre mekanizmave të pavarur se çfarë vërtetë janë duke kontribuar në luftimin e këtyre dukurive.

Do të doja që vërtetë që edhe si njerëz që jemi në institucione, por edhe jashtë institucioneve si shoqëri civile, si shoqëri në përgjithësi ta nxjerrim një konstatim që i duhet këtij vendi. A jemi vërtetë të gjithë të gatshëm ta luftojmë korrupsionin? Unë po dyshoj se nuk jemi. Dhe nëse ne jemi të gjithë për ta luftuar korrupsionin unë jam i bindur se ai do të luftohet. Por, ende nuk e kemi vullnetin e të gjitha palëve. Unë mendoj se nuk duhet monopolizuar faji dhe nuk do të duhej adresuar gishti vetëm në një drejtim.

Po derisa ne kemi këtë shkallë kaq të lartë të korrupsionit, kjo sigurisht se e bën të qartë edhe faktin se kemi pjesë të tëra të shoqërisë që janë pjesë e kësaj dukurie të ligjshme. Prandaj, do të duhej një mobilizim i përgjithshëm i të gjitha këtyre hallkave në mënyrë që vërtetë të mos jetë vetëm gishti i drejtuar nga njëra palë, nga njëra anë, por që faktikisht janë palë edhe të tjera të involvuara prandaj fatkeqësisht kemi një shkallë të lartë të korrupsionit dhe të perceptimit për të.

Lidhur me Agjencinë duke përfunduar, sepse ne po e kemi këtë dëgjim publik me drejtorin, por drejtorin e keni drejtor تازه sapa ka filluar punën dhe ne kemi qenë edhe pjesë e intervistës dhe e kemi vlerësuar se është drejtori do të mund t'i bëjë ballë sfidës së drejtorit dhe sigurisht që presim përgjegjësi, sepse është një lloj adresimi sikur vetëm Agjencia do të duhej ta luftonte korrupsionin dhe kjo nuk është e saktë. Por, ajo që do të bëja në formë të pyetjes dhe për të hapur debatin e juaj i nderuari zoti drejtor tashmë i bëtë disa muaj që jeni aty, çfarë gjetët keq dhe çfarë gjetët mirë.

Çfarë gjetët keq që ta mënjanoni? Dhe çfarë gjetët mirë që ta avanconi në kuptimin që punët e Agjencisë të shkojnë më mirë? Pjesë e raportimeve, debateve që kemi pas edhe si komision edhe si Kuvend, edhe ju e konstatuat këtu po është edhe pjesa e tyre statistikave që thamë është hudoja e lëndëve. Edhe njëherë ta kam shtruar këtë pyetje, por tash ka kaluar një kohë. Vërtetë e keni identifikuar që është pjesë e mekanizmave profesional brenda agjencisë, nëse është ashtu çfarë keni menduar që të ndërmerri hapat. Do të kërkon zgjerim të kapaciteteve apo ngritje të këtyre kapaciteteve në kuptimin e trajnimeve, sepse jo rrallëherë është konstatuar që shumë lëndë nga Agjencia janë hedhur poshtë edhe për shkak të jo profesionalizmit.

Një çështje që nuk lidhet prej kohës kur ju e keni filluar mandatin e juaj, është çështja e prokurimeve të ashtuquajtura të imta e që kanë kaluar në prokurim elektronik, mirëpo ka qenë një lloj azhureteti i madh i institucioneve të caktuara për prokurime të tilla që në muajin janar të bëjnë prokurime të tilla, sepse ka qenë një kohë kur është dashur të futet në fuqi prokurimi elektronik edhe sikur ata i kanë ikur kësaj kohe dhe e kanë shfrytëzuar muajin janar. Keni filluar të bëni diçka në këtë drejtim apo keni hasur diçka të tillë. Edhe njëherë duke përfunduar, i nderuari drejtor, kemi thënë edhe më herët do ta kesh përkrahjen e komisionit dhe në përgjithësi të Kuvendit që të artikulon qartë çfarë ju duhet si Agjenci, qoftë edhe ndryshimin e pjesës së ligjeve që prekin fushë veprimtarinë e juaj, por kjo nuk do të thotë vetëm aty, mund të japim kontributin edhe për pjesën tjetër të legjislacionit.

Me rëndësi është që të gjithë të bëhemi praktikisht të krijojmë besimin te qytetarët se në Kosovë ka institucione dhe ka njerëz të ndershëm dhe të mirë që duan të mirën e këtij vendi për të luftuar këtë dukuri negative. Jo që nuk ka korrupsion edhe në shtetet e rajonit, jo që nuk ka korrupsion edhe në shtetet e BE-së dhe më larg, por atje ka institucione megjithatë që luftojnë dhe është ndërtuar besimi se megjithatë ka njerëz të dënuar për veprat që janë në kundërshtim me ligjin. Faleminderit, kryetare! Ju faleminderit të pranishëm!

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu! Zoti Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

I nderuar zoti Sheholli, përfaqësues të Ambasadës,

Të gjithë ju të pranishëm të organizatave joqeveritare, media

Sapo po i dëgjoja kolegët e mi po del ajo e kundërta që e thonë krerët e shtetit që korrupsioni është perceptcion, perceptim apo është gjendje reale. Unë mendoj që Kosova është duke u ballafaquar me nivelin më të lartë të korrupsionit, dhe pse vije deri te kjo gjendje mendoj që ne mos të flasim për institucionet që janë me ligj të ndara, por mund të them a kemi gjyqtar autonom, a kemi prokurorë autonom dhe a kemi qytetarë autonom.

Kur e them këtë mendoj që në botën perëndimore çdo gjyqtar është autonom dhe e bën punën e vetë, jo çka i thotë politika, jo çka i thotë kryetari i gjykatës, por është i pavarur për lëndët që i përcaktohen. E njëjta gjë është për prokurorët apo për prokurorin, dhe po ashtu e njëjta është për qytetarin. Kur e them qytetari autonom e them sa siguri dhe sa besueshmëri ka qytetari jonë për të dhënë një sinjalizim që diçka po ndodh tek ky zyrtar apo tek ky institucion. Derisa bazën themelore nuk e trajtojmë ashtu siç duhet, siç është qytetari, që është sinjalizuesi i parë i një të keqe që ndodh në institucion mendoj që kot ne e kemi këtu të kemi javë anti korrupsion, të kemi tryeza apo që ne të mendojmë që mund ta luftojmë korrupsionin.

Ajo që duhet të themi mendoj që edhe qytetari shpesh ballafaqohet apo zyrtarët edhe këtë duhet ta themi në padrejtësi. E them këtë sepse mund të ketë perceptim për një zyrtar që është i korruptuar dhe nëse ti e burgos një zyrtar me dëshmi të rrejshme, dhe me jo dëshmi argumentuese atëherë çka i bjen kjo. Po ashtu, është e njëjta edhe për shumë qytetarë të thjeshtë që mbeten nëpër burgje pa argumentuar dëshmi, por duke u bazuar në dëshmi të arsyeshme. Nuk burgoset njeriu me dëshmi të arsyeshme, por duke i argumentuar. Në këtë drejtim mendoj, që korrupsioni nuk mund të luftohet me tryeza, korrupsioni nuk mund të luftohet vetëm për një javë, po korrupsioni luftohet në mënyrë sistematike, duke u bazuar në ligjet, që unë mendoj se ligjet janë mjaft të arsyeshme, mirëpo është faktori njeri që nuk është autonom për të luftuar korrupsionin.

Derisa të ketë përzierje në të gjitha institucionet, në zinxhirin komandues, prej lartë poshtë dhe prej poshtë lartë, mendoj se ne kot e kemi që ta luftojmë korrupsionin dhe mendoj se në këtë drejtim na mbetet shumë, shumë punë. Derisa e pranon vet pushteti që ka korrupsion në nivelin më të lartë, atëherë si mund tani dikush tjetër, edhe kur është e argumentuar kjo që kemi korrupsion në nivelin më të lartë, atëherë diçka është vetëm qytetari mund ta ndryshojë këtë gjendje.

Tani, po flasim për vitet e ardhshme, për të krijuar resurse njerëzore që janë autonomë, profesionalistë. Shikoni rezultatin se çfarë niveli të arsimit kemi. Ne po e shkatërrojmë me vetëdije vendin tonë, sepse ne presim prej gjeneratave të ardhshme, pa hipoteka, që të jenë edhe të jenë në vende kyçe. Dhe, kjo mendoj që

ne si shoqëri e tërë duhet të angazhohemi, prej qytetarëve e deri te gjyqtari e prokurori autonom. Përndryshe, nuk guxojmë ta bëjmë edhe të vijnë, ne duhet të jemi mirënjohës prej ndërkombëtarëve, por ne duhet ta bëjmë punën tonë për hir të qytetarëve tanë, për hir të shoqërisë tanë, jo për hir të një miku tim që e kam këtu, ose dikujt tjetër. por, ne duhet që të nisemi, t'i kryejmë detyrat dhe obligimet tona si vendorë, jo sepse erdhi dikush, ambasada evropiane apo kujtdo nga Evropa, edhe ne atëherë të bëhemi kinse po e luftojmë korrupsionin. Ne duhet t'i kryejmë detyrat tona për hir të sistemit dhe shoqërisë në përgjithësi dhe ta kemi në fokus qytetarin. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Lekaj!

Unë s'pajtohem me kolegët e mi kur thonë, se pakoja ligjore aktuale mjafton, për faktin se besoj që është koha e fundit, nuk mundoj që është e mirë, e di se në qoftë se kishte pasur vullnet politik, disa raste do të kishin mundur të zgjidhen edhe me këtë pako ligjore, por besoj se është koha e fundit kur Kosova duhet ta ketë ligjin anti-mafia.

Po dua ta ndaj me ju këtu, kur kam pyetur këshilltarin e ministres aktuale të Drejtësisë, se përse keni hequr dorë nga ligji anti-mafia, ka thënë “sepse Kosova nuk ka Mafi”. Unë mendoj, se deklaratat e tilla janë joserioze dhe besoj se po, është tepër e rëndësishme që Kosova ta ketë ligjin anti-mafia. Unë e kuptoj, që kjo Qeveri s'do ta bëjë, por natyrisht që ne duhet të angazhohemi që ta kemi një të tillë, ku barra e provës vendoset tek i dyshuari dhe jo siç është aktualisht. E di që me Betimin nuk pajtohem në këtë drejtim, por megjithatë po ia jap fjalën, në mënyrë që ta thonë edhe qëndrimin e vet.

Por, po e shoh që zoti Havolli ka për të shtuar, për tu përgjigjur për deputetin Aliu dhe pastaj vazhdojmë me Betimin, Artonin, Fisin, dhe të tjerët. Faleminderit!

Shaip HAVOLLI: Faleminderit, kryesuese!

Ishin disa pyetje, se si e gjeta agjencinë, të mirat dhe të këqijat.

Kryesisht, agjencinë e kam gjetur një agjenci stabile. Cilat janë veprimet e para që i kam ndërmarrë? Domethënë, veprimet e para që i kam ndërmarrë me të shkuar në agjenci, kryesisht jam fokusuar në fushën e hetimit dhe konkretisht e kemi diskutuar çështjen e rasteve, hedhjen e kallëzimeve penale. E kam vërejtur që kanë një mungesë të trajnimeve në fushën penale.

Menjëherë pas kësaj kam bërë një projekt ideor dhe ka qenë edhe kërkesë e OSBE-së, nëse keni ndonjë interesim në fushë të caktuar. Unë kam kërkuar që të bëhet një trajnim në fushën e çështjeve penale të korrupsionit, në fushën e deklarimit të

prejardhjes së pasurisë dhe në fushat tjera me karakter penal. Kështu që, edhe gjatë hartimit të raporteve dhe sjelljeve të raporteve për çështjet penale, ka disa raporte edhe ua kam kthyer për plotësim, duke shfrytëzuar edhe përvojën time në fushën penale. Kështu që, po besoj se kualiteti i kallëzimeve penale do të përmirësohet.

Po ashtu, siç thash edhe te çështja e këtyre prokurimeve, në fund të vitit zakonisht si në shpejtësi kryhen disa prokurime, pa zotime, pa... edhe aty tash kemi mbi 90 opinione që janë dhënë, të cilat disa autoritete kontraktuese edhe kanë kërkuar falje, kanë thënë "... fundi i vitit..." edhe e kanë pranuar që kanë gabuar lidhur me këto aktivitete të prokurimit.

Te çështja legjislative, thash se ka disa mangësi në fushën legjislative, te konflikti i interesit ka pasur shumë paqartësi rreth sjelljeve të disa vendimeve. Te çështja e deklaramit, se atëherë pak në një fazë pak harrova, te çështja e trashëgimisë. Trashëgimia s'ka çka të vlerësohet. Trashëgiminë e ke prej babës, prej dikujt... edhe aty është një problem, se s'di si ta vlerësojë njeriu. E ka trashëgimi, ia qet vlerën 1 milion... Domethënë, edhe kjo çështje duhet... tani edhe niveli po rritet, niveli i milionerëve po bëhet, domethënë, se aty tani ka edhe mundësi manipulimi.

Domethënë, janë shumë çështje që duhet të adresohen dhe të rregullohen, sa i përket çështjeve. Unë po them, se ekziston baza ligjore e mjaftueshme për ta luftuar korrupsionin, nuk mund të ankohemi shumë në atë, por ka nevojë ende. Unë mendoj që ka nevojë ende të përmirësohet baza ligjore. Kjo ishte në pika të shkurtra, sa i përket kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Havolli! Zoti Musliu.

Betim MUSLIU: Faleminderit, Albulenë. Por, Fisi me gjasë duhet të shkojë, kështu që ndoshta do ta kryejë shumë shkurt.

(Ndërprerje e incizimit.)

Betim MUSLIU : Atëherë, përshëndetje të gjithëve.

Më së pari një falënderim për Ambasadën Amerikane, e cila mbështet krejt këtë aktivitet të kësaj jave kundër korrupsionit.

Përshëndetje të gjithëve dhe ju falënderoj për qasjen që unë sot po e dëgjoj prej deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, njihem edhe individualisht me pjesën dërmuese të juaj. Ky diskurs sot në fakt më bëri shumë përshtypje dhe më inkurajoi dhe shpresoj se nuk do të mbetet një diskurs, që jemi mësuar ndoshta ta

shohim te pjesa tjetër e politikës, që është shndërruar në retorikë, e që nuk po prodhon kurrjë prej pasojave që do të duhej t'i prodhojë. Sot, po them, po ndihem mirë për këtë pjesë.

Vetëm t'ia jap këtë përgjigje kryetares së komisionit, për sa i përket ligjit, dhe vazhdojmë me pjesën tjetër, qysh e mendova unë. Ne, në fakt si organizatë joqeveritare, nuk pajtohemi me këtë ligjin anti-mafia për shkak të, ndoshta një milionë arsye nuk janë, por për shkak të shumë arsyeve, të cilat i kemi theksuar edhe më herët. Ne mendojmë se nuk jemi gati njëherë si shoqëri, që me e pas këtë ligj, për shkak të brishtësisë së sistemit të drejtësisë dhe ndikimit pikërisht politik në sistemin e drejtësisë dhe mendojmë se, nëse do të bartej barra e të provuarit apriori tek i pandehuri për ta vërtetuar pasurinë e vet, konsiderojmë se kjo do të ishte një eskavator që do ta përdornin politika përmes institucioneve të drejtësisë për të shkatërruar pikërisht kundërshtarët politikë.

Ky është shqetësim që ne mendojmë se ky ligj do të mund të keqpërdorej skajshmërisht, pikërisht për shkak të politikës në sistem të drejtësisë. prandaj, pa e pavarësuar edhe praktikisht, siç e kemi formalisht sot sistemin e drejtësisë, nuk mendojmë se një ligj i tillë do t'i shërbente luftës kundër korrupsionit. Madje, është ajo që më së shumti neve si organizatë na shqetëson e që vjen prej vetë bartësve të funksioneve gjyqësore prokuroriale, të cilët sot me ngulm janë duke e kërkuar këtë ligj anti-mafia, se po thonë “ne veç përmes këtij ligji do të mund të rrimë në zyrë...” edhe qysh janë e masandej me thënë “hajde, dëshmoje ti, kah e ke marrë këtë banesë, kah e ke marrë këtë kerr...” edhe ata pastaj të mos punojnë bash kurrjë hiq po veç të rrinë e të presin prova në zyrë, sepse kjo do të ishte mundësi që ua ofron ligji.

Kështu që, shteti sot i ka krejt mekanizmat e mundshëm në dorë për të vërtetuar kryerjen e cilësdo vepër penale dhe nëse me gjithë këtë ushtri që e ka shteti nuk arrin ta vërtetojë një korrupsion, atëherë pse duhet qytetari të ngarkohet me këtë. Kështu që, po besoj se as barazia e armëve, as kurrjë hiq nuk do të ishte korrekte, nëse vazhdojmë, bëhemi një vend ku sundon ligji siç duhet, atëherë edhe ky ligj do të ishte në rregull dhe do t'i shërbente, besoj, luftimit të pasurisë së paligjshme. Ky është mendim i organizatës tonë.

Lufta kundër korrupsionit, shumë strategji, shumë mekanizma edhe, thash, më inkurajoi sot diskursi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që po i pranojnë edhe dështimet që sot e shumë vite janë prezente. Në fakt, vullneti politik është ai që ka munguar për ta pasur një sistem të pavarur gjyqësor dhe përveç ndihmës që është dhënë nga faktori ndërkombëtar, nuk e kemi parë ndoshta edhe pjesën e rezultateve

që është pritur prej tyre, sepse edhe nga UNMIK-u e më pas edhe nga EULEX-i, kemi pritur rezultate në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, kompetencë kjo që ka qenë ekskluzive dhe që nuk është shfrytëzuar si duhet, sepse kemi parë që ka pasur raste, ka pasur spektakle por që në fund kanë munguar ato aktgjykimet përfundimtare.

Pra, një pjesë e faturës së dështimeve për këtë luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë ia dërgojmë, gjithsesi, UNMIK-ut dhe EULEX-it. Assesi, kjo nuk e ka penguar asnjëherë sistemin e drejtësisë vendore që të dëshmojë rezultat dhe kjo është një prej arsyeve që realisht janë fshehur vazhdimisht prokurorët dhe gjykatësit vendor për të mos bërë ndjekje dhe gjykim të këtij profili, me arsyetimin se “jo, me këta merren ndërkombëtarët...” e në fakt, asnjë pengesë nuk e kanë pasur kurrë.

Por, meqenëse ka pasur bartës të funksioneve, sidomos në pozitat kyçe që janë zgjedhur, po them, jo formalisht por praktikisht, përmes ndikimit politik, në pozita kyçe sidomos, janë dërguar njerëz që kanë pasur dhe kanë shantazhe të ndryshme, të cilat mund tu përdoren atyre sa herë që ata mendojnë ta luftojnë korrupsionin dhe korrupsioni më i madh në këtë vend nuk janë këto 10 – 20 euro që “mbaruan” duke i zënë doganierët e këdo rrugës, por është korrupsioni që ne po i themi “politik”, janë korrupsioni dhe veprat penale, që lidhen me fushën e prokurimit dhe vepra penale të korrupsionit që janë më komplekse. Në këtë pjesë kemi pa dhe po shohim mungesë të vullnetit për tu marrë sistemi i drejtësisë.

Por, tash diçka që është shumë shqetësuese e që u lidh edhe me kërkesën e deputetëve për të marrë përgjigje nga zoti Havolli, ka të bëjë me numrin e madh të rasteve, të cilat hedhen dhe pushohen. A ka qytetarë që e denoncojnë këtë veprimtari të dëmshme, që e denoncojnë korrupsionin? Po more, qysh jo! Prej vitit 2000 ka pasur kallëzime penale në Prokurori, sot hala në Prokurorinë themelore të Prishtinës është një rast i vitit 2002, që është denoncuar nga një qytetar për veprë penale të korrupsionit e ky rast nuk është trajtuar ende asnjëherë. E thash, çka i kemi dhënë mesazh ne këtij qytetari, që kurrë në jetë ai s’duhet tu drejtohet këtyre institucioneve, sepse jo që nuk ka mbajtur përgjegjësi ai që e ka kryer ose është dyshuar që e ka kryer veprën, por ky është ai që është persekutuar në vazhdimësi, sepse ka lindur një seri problemesh me këtë qytetar që e ka denoncuar korrupsionin.

Prandaj, përveç këtij denoncuesi që është përballur me 100 probleme është edhe ai që është i denoncuar me shumë probleme, sepse një qytetar i cili mund të jetë

cilido prej nesh, mund të jetë subjekt i një kallëzimi penal të kujtudo qoftë dhe a meriton të persekutohet për 10 a 20 vjet. Kjo është çmenduri.

E pash kërkesën, në fakt, për të marrë një vlerësim nga kryetarja e komisionit nga drejtori i agjencisë në lidhje me parashkrimin e veprave penale. Unë e kam parë një raport të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ne si institut jemi duke analizuar një draft, në fakt, një raport të shkurt të një analize ligjore që i është bërë nenit 159, që ka të bëjë me zgjatjen e hetimeve, me zhvillimin e hetimeve, për veprat penale. E kemi parë një rekomandim që na ka shqetësuar jashtëzakonisht shumë dhe po besojmë që është paradoksal, që sidomos ka ardhur prej Avokatit të Popullit, që ka të bëjë me heqjen e afatit të hetimeve për veprat penale të korrupsionit. Për ne kjo është çmenduri, sepse absolutisht kjo nuk krijon kurrfarë sigurie juridike për askënd. Kjo i bie që kushdo prej nesh këtu mund ta bëjë një kallëzim penal dhe mund të nisë një hetim nga Prokuroria, i cili mund të zgjasë 102 vjet, sepse s'ka afat të hetimit, e kjo është skandal i llojit të vet, e para. E dyta, a duhet të parashkruhen veprat penale të korrupsionit? Po, duhet të parashkruhen dhe kjo është standard në drejtësinë penale që është vendosur dhe duhet të avancohet, por assesi nuk duhet të hiqet. Nëse shteti nuk ka gatishmëri, nuk ka mekanizma, për ta ndjekur a gjykuar dikë për 10 a 20 vjet, për sa është afati i paraparë ligjor, atëherë çka me i bë atij njeriu? Dikush që e ka bërë një herë një gabim, a duhet përjetësisht tash me u... ne shkojmë e i dërgojmë njerëzit në burg për t'i risocializuar dhe për t'ia kthyer normal shoqërisë. Atëherë, cila është ideja këtu? Domethënë, parashkrimi është institut i të drejtës penale, që është gjithkund në botë, edhe për vepra penale të korrupsionit duhet të jetë dhe kjo mund të diskutohet, se nëse duhet për vepra penale të caktuara të zgjatet afati i parashkrimit, nëse na e kemi problem t'i zëmë disa njerëz, qysh edhe po i gjykojmë e po na ikin e po bëjnë aktivitetet nëpër "suedia", hajde të shohim për ato vepra penale, çka mund të bëjmë që t'i zgjasim afatet. Por, mos me pas afat të parashkrimit, kjo është diçka që s'na... s'na... nuk guxon të ndodh.

Tek vullneti politik, që mos ta zgjas shumë, unë besoj se vullnetin politik do të duhej që ta shprehnit në atë që e adreson vazhdimisht raporti i progresit, se nganjëherë kur bëjmë edhe gjetje, megjithëse sot, po them, debat jashtëzakonisht konstruktiv, kur bëjmë publikime të shumta ne shoqëria civile nganjëherë merremi jo fort kredibile nga ana e disa deputetëve ose sidomos e qeveritarëve, me arsyetime të ndryshme, por të njëjtat gjëra thuhën edhe në raportin e progresit e më pas, ndryshe pranohen.

Vullneti politik nuk di qysh ndryshe duhet të shpjegohet, përveçse e keni një seri të militantëve në ndërmarrje pubike. Unë nuk besoj që as evropianët e as amerikanët,

që kanë ndihmuar kaq shumë këtë vend, kërkojnë që Qeveria ose deputetët të çohen e të ngrenë aktakuza, se i kemi prokurorët. Po, çfarë mund të bëjë secili prej këtyre bartësve të këtyre funksioneve, është që të mos shtrojë ndikimin aty ku nuk duhet. Andaj, depolitizimi është një prej mënyrave qysh shprehet vullneti politik për ta luftuar korrupsionin.

Dhe, krejt te çështja e fundit, vërtet është një nevojë që e kemi zgjatur, në fakt e kemi përsëritur vazhdimisht si institut i Kosovës për Drejtësi dhe që ka të bëjë me një rishikim të sektorit të drejtësisë, rishikim të sektorit të drejtësisë penale. Ne nuk mund të vazhdojmë më me këtë sistem të drejtësisë, i cili ka besueshmëri 18%. Besimi në sistemin e drejtësisë e legjitimon drejtësinë që e ndajnë gjyqtarët dhe prokurorët dhe është e paimagjinueshme që me këtë nivel të kënaqshmërisë së qytetarëve në sistem të drejtësisë të vazhdohet, domethënë çdo vendim që e marrin këta ne nuk i besojmë. Kjo i bie që duhet edhe një herë një proces që e kemi kaluar me e rikthye në Kuvendin e Kosovës dhe këtu duhet të shprehet prapë vullneti politik.

Duhet bërë ndryshime kushtetuese dhe ligjore dhe me hy edhe një herë në proces të rishikimit, të riverifikimit, të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nuk mund të vazhdojmë më me këta njerëz. Nuk po them se nuk ka të mirë, qysh ka edhe në sistem prokurorial... edhe... po, po, absolutisht, jo tash prej politikës po buron. Unë po them prej këtu buron vullneti politik. Mos të bëjmë përgjithësime, jo në krejt sistemin prokurorial, jo në krejt sistemin gjyqësor janë të këqij, as në Kuvendin e Kosovës nuk janë krejt të këqij. Domethënë, ka njerëz të cilët... ta bëjmë një ndarje edhe ta adresojmë përgjegjësinë individualisht. Ja një çështje që lidhet pikërisht me vullnetin politik dhe që është jashtëzakonisht shqetësuese edhe që kemi reaguar publikisht.

Unë ende tmerrohem qysh vullneti juaj si deputetë të Kuvendit të Kosovës, sepse keni qenë edhe ju që... s'e di individualisht kush ka votuar, por është kjo legjislaturë, në ndryshimet e pakos së ligjeve të gjyqësorit, është bërë atje një dispozitë e cila mundëson amnisti të përgjithshme sjelljeve të pahijshme të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Eh, po njëmend kjo është e turpshme. Kjo është shumë e turpshme! Është e papranueshme qysh keni vendosur përmes ndryshimeve ligjore me u bë amnisti të përgjithshme gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë bërë sjellje të pahijshme. Po, po, veç nuk parashkruhen, absolutisht po. Jo, jo, jo, Albulenë mos keqkupto... mos më keqinterpreto. Janë shkelje etike, por janë shkelje etike deri në pesë vjet, jo politika me ua kthye argatin njerëzve që u kanë kryer punë, se qe kjo ka ndodhur.

Mendime për parashkrim, kurrë në jetë, ajo është standard në drejtësinë penale, Albulenë. Ato janë baza që kurrkund në Botë nuk ekzistojnë. Faleminderit! Jam i gatshëm të kyçem prapë.

KRYETARJA: Faleminderit!

Fisnik Korenica Po shpresoj që ky rast i vitit 2002, Betim, ka me u zgjidhë gjatë javës kundër korrupsionit dhe me u mbyllë si shembull i keq në luftën ndaj korrupsionit.

E para, sa i takon parashkrimit që përmendi Betimi, vetëm shkurtimisht po e përmendi. Ky ka qenë një version që ka ardhur prej Ministrisë së Drejtësisë dhe i përkrahur prej Zyrës së Bashkimit Evropian dhe unë besoj që komisioni ka tentuar të parandalojë dy-tri herë këtu, por nuk ka arritur në fund të fundit, për shkakun që kishte një insistim prej ministrisë së atëhershme edhe prej vetë Zyrës së BE-së, që të ishte ashtu, unë pajtohem që është gabim dhe kam qenë njëri prej atyre që kam kundërshtuar. Shumica prej deputetëve në atë kohë patën kundërshtuar, por kështu shkoi.

Po dua fillimisht ta falënderoj komisionin që ka pranuar të organizojë këtë dëgjim publik, kryetaren e komisionit, të gjithë anëtarët pa përjashtim.

Mendoj që është hap pozitiv, të paktën, fakti që të gjithë deputetët sot po e pranojnë që korrupsioni i lartë në Kosovë nuk është thjeshtë çështje perceptimi, është një realitet. Dhe, nëse asgjë tjetër, java kundër korrupsionit besoj që ka arritur që të paktën këtë diskurs, këtë energji publike ta nxjerrë dhe ta shprehë publikisht. Për ta bërë një krahasim, dje kishim një takim me përfaqësues të sistemit të drejtësisë. Imagjinoni, ata insistonin që korrupsioni në Kosovë është thjeshtë çështje perceptimi, është një produkt media dhe produkt i shoqërisë civile. Mua po më vjen mirë që një logjikë e tillë unë sot nuk e pash në asnjërën prej fjalimeve të deputetëve dhe kjo, besoj të paktën deklarativisht, është një hap për të cilin ne duhet të ju vlerësojmë të gjithë juve këtu e në anën tjetër t'ua bartim një barrë të madhe të përgjegjësisë dhe të Sistemit të Drejtësisë.

Tri gjëra po i përmend shumë shpejt, ku mendoj se Komisioni për Legjislacion duhet të bëjë punë më të madhe, por njëkohësisht edhe Agjencia Kundër Korrupsionit. E para ka të bëjë me një vlerësim vjetor, që duhet bërë strategjisë kundër-korrupsion 2013-2017. Aktualisht, modeli që shfrytëzon Agjencia Kundër Korrupsionit për ta monitoruar zbatimin e strategjisë, për të mos thënë që është krejtësisht josubstancial, shpeshherë më duket edhe qesharak, dhe unë po çuditem

se si Komisioni për Legjislacion, pavarësisht që shpeshherë ka pasur iniciativë, nuk është marrë me një gjë të tillë pak më seriozisht. Pra, as nuk i duhet dhënë luksi Agjencisë, që të paraqesë raporte për një strategji që është strategji e Kuvendit, por në anën tjetër besoj se edhe vetë komisioni duhet të jetë më syhapur, që të mos lejojë që një strategji e cila në vitin 2013 ishte nxjerrë me aq shumë pompozitet, kishte qenë një prej kushteve të para në procesin e liberalizimit të vizave. Kaluan pothuajse 3 – 4 vjet dhe kemi ardhur në një fazë, ku progresi i zbatimit të saj është krejtësisht minimal. Këtu besoj se përgjegjësi themelore duhet të ketë edhe vet komisioni dhe vet Kuvendi. unë ju inkurajoj që të mos e lejojmë agjencinë që me monitorimin e kësaj strategjie të bëjnë terma kaq abstrakt me shumë pak përgjegjësi dhe shumë pak adresim të përgjegjësive.

Në këtë pikë, unë besoj që gjithashtu duhet përmirësuar raportimi i agjencisë në raport me komisionin. E shoh, se raportimi përfundon me përfundimin e mbledhjes së komisionit, mendoj se nuk duhet të jetë një praktikë e tillë. pra, komisioni duhet qëndruar pas çdo përgjigje të agjencisë dhe duhet këtë ta shtojmë në një nivel të një mekanizmi të kontrollit të përhershëm, në baza mujore, dymujore, tremujore, por ne nuk e kemi luksin që ta luftojmë korrupsionin thjesht përmes një diskutimi, që përfundon me fjalime të bukura por që nuk ka veprime pasuese, që përcjellin progresin ose jo, qoftë të këtyre që i thotë drejtori i Agjencisë, qoftë atyre që thonë institucionet tjera përgjegjëse.

Sa i takon prejardhjes së pasurisë dhe kallëzimeve penale, që bën Agjencia Kundër Korrupsionit, unë mendoj se aty ka një defekt shumë të madh. E para, një kallëzim penal kur e bën Agjencia Kundër Korrupsionit, një kallëzim i tillë duhet ta plotësojë standardin e bindjes së arsyeshme, pra Agjencia nuk mund të bëjë një kallëzim i cili nuk plotëson standardin e bindjes së arsyeshme, që dikush ka bërë vepër penale. Prokuroria arsyeton që shumica e kualifikuar e kallëzimeve penale që vijnë prej agjencisë nuk e kalojnë standardin e bindshmërisë së arsyeshme, sa i takon një vepër të caktuar penale.

Kështu që, këtu kemi një defekt dhe ne duhet ta gjejmë kush është fajtori, ose agjencia po bën kallëzime penale që nuk e plotësojnë standardin e kërkuar të kodit të procedurës penale, ose Prokuroria po gënjen dhe këto që janë kallëzime penale që duhet të shndërroheshin në hetime, që të përfundonin, të paktën, në një shumicë të konsiderueshme në aktakuza. Prokuroria po refuzon t'i bëjë, sepse ose ka frikë, ose nuk është e gatshme për t'i proceduar. Ama, ne s'mund ta lëmë fajin diku në mes, pra faji aktualisht ka mbetur në mes, as nuk e dimë a i takon faji agjencisë a Prokurorisë. Përcaktimi i fajtorit besoj se është indikator themelor, përmes të cilit

ne e gjejmë përgjegjësin, kështu pa përgjegjës vështirë se do të zgjidhim ndonjë gjë.

Sa i takon legjislacionit, unë pajtohem me një shumicë të madhe me arsyetimin e Betimit, legjislacioni absolutisht ka hapësirë të bollshme për të mos thënë që legjislacioni u jep institucioneve të sistemit të drejtësisë më shumë hapësirë, se sa çdo legjislacion në shtetet e zhvilluara për ta luftuar korrupsionin dhe këtu, definitivisht, nuk është problemi tek legjislacioni, është problemi tek vullneti i këtyre institucioneve për ta bërë punën e tyre si duhet dhe për të qenë të pavarur prej politikës. E kur jemi tek pavarësia, unë jam ithtar dhe kam filluar të bindem, që kjo pavarësi e tepërt që ua keni dhënë institucioneve është shndërruar në pavarësi edhe ndaj përgjegjësisë. Pra, këto që ngriti deputeti Aliu, unë mendoj se është plotësisht me vend, pavarësia në asnjë moment nuk nënkupton që një institucion ka fituar imunitet ndaj përgjegjësisë.

Kështu është situata aktualisht. Ligjet që i kemi nxjerrë ne kanë shkuar në drejtimin e një pavarësie të hekurt, ku institucionet, në fakt, nuk ndjehen as përgjegjëse. Sistemi i Drejtësisë aktualisht është krejtësisht i papërgjegjshëm, nuk i jep askujt llogari dhe prandaj jemi në situatën ku jemi. Pra, pavarësinë duhet ta rikonceptojmë, ta shohim se në fakt mos po u japim tepër pavarësi, në masën e tillë që kjo pavarësi të keqpërdoret, të shndërrohen, të ndërtohen plane institucionale që më shumë e pengojnë luftën ndaj korrupsionit, se sa që e ndihmojnë atë. Dhe, ligji i ri që shpejt propozohet prej Ministrisë së Drejtësisë e që është një produkt i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, unë mendoj se është një hap i mirë, po i referohem Ligjit për përgjegjësinë disiplinore, është një produkt shumë i mirë që mund të hap rrugë, mund të hap rrugë, s'po them se do të hapë, për ta bërë Sistemin e Drejtësisë më të përgjegjshëm. Por, kjo duhet shikuar më tutje.

Edhe pikën e fundit, shpeshherë po e shoh që jemi bërë robër të statistikave. Domethënë, edhe sa i takon Agjencisë Kundër Korrupsionit edhe sa i takon Prokurorisë edhe gjykatave po serohemi me statistika të cilat duket se na dërgojnë diku, por s'po na dërgojnë askund. Këtu ndoshta komisioni duhet të luajë rol më të rëndësishëm. T'i marrim statistikën në një formë, e cila shpjegon nëse luftohet korrupsioni substancialisht apo jo. Pra, statistikën nuk mund të jenë instrument për të na mashtruar. Unë mendoj, se aktualisht statistikën janë bërë instrument i mashtrimit dhe ne nuk duhet ta lejojmë këtë kurrësi. Është shumë e qartë, se lufta ndaj korrupsionit ka tepër pak progres, ka tepër pak progres, dhe ne duhet që të mos e lejojmë këtë progres të dëmtohet tutje me keqpërdorim të statistikave. Për të mos i hyrë në hak drejtorit të ri të Agjencisë, kritikën ndaj agjencisë nuk mund t'i

atribuohen krejtësisht drejtorit të ri, sepse ky sapo ka ardhur në detyrë, por më shumë janë kritika ndaj mënyrës se si ka funksionuar agjencia këto dhjetë vjet. Fatkeqësisht, hapat e parë që po ndjek drejtori i ri, e unë po shpresoj se ky do të bëjë kthesë e jo që të bëjë vazhdimësi të një pune, e cila pavarësisht se mund të dukej e bukur me drejtorin e kaluar, nuk sillte rezultate konkrete kurrsesi. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, Fisi! E para, vetëm disa çështje, pajtohem se Komisioni për Legjislacion është dashur të bëjë një vlerësim serioz të strategjisë kundër korrupsionit 2013/2017. Ne së voni kemi nisur angazhimin pak më të madh, sa i përket rolit tonë në mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, kemi formuar grupin punues që udhëhiqet nga zonja Valdete Bajrami dhe aty në plan të punës është mbikëqyrja e kësaj strategjie. Nëse ju kujtohet, opozita në atë kohë s'e pati votuar këtë strategji, pikërisht për shkak të problemeve të kësaj strategjie.

Sa i përket pakos ligjore dhe çështjes që e përmendi, për parashkrimin, që e përmendi zoti Musliu, vetëm dua ta theksoj faktin që edhe ju si organizatë e Shoqërisë Civile keni qenë në grupin punues të Komisionit për Legjislacion dhe mendoj që është dashur të ngritët në atë kohë kjo çështje dhe jo të lejohet që e njëjta të kalojë, në qoftë se ka pasur kundërshtime.

Sa i përket disa çështjeve të tjera, të cilat i përmendën këtu edhe për Ligjin anti-mafia, unë mendoj se nuk po them dhe nuk është kërkesë imja që vetëm ta nxjerrim Ligjin anti-mafia pa e forcuar sistemin e drejtësisë, askush nuk po e kërkon këtë, sepse është e vërtetë se mund të vendoset qytetari në këtë arbitraritetin juridik. Por, paralelisht me forcimin e Sistemit të Drejtësisë, fuqizimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, natyrisht se duhet të kompletohet edhe pakoja ligjore kundër korrupsionit.

Po dua ta ndajë me juve, ishim në një vizitë në Shqipëri për tu njoftuar me reformën në drejtësi, me theks të veçantë të Ligjit për **vetëingun**. Edhe Kosova është tepër e domosdoshme që ta ketë Ligjin për **vetëingun**, por po ashtu ata kishin bërë ndryshime, sa i përket luftimit të korrupsionit që e kishin fuqizuar, të paktën me ato ligje që kanë kaluar në Kuvend të Shqipërisë, një departament të veçantë të prokurorëve, i cili do të merret me rastet e korrupsionit. Më besoni, që unë kam takuar prokurorë të cilët më kanë thënë se neve na vijnë raste të korrupsionit por nuk kemi aftësi për t'i hetuar. Do të thotë, duhet të ketë profilizim të prokurorëve por edhe të gjyqtarëve dhe një departament i veçantë përbrenda prokurorisë që do të merret vetëm me rastet e veprave korruptive.

(Ndërhyrje)

Do të thotë ky është mendimi im dhe përvojat të cilat i kemi marrë në Kuvendin e Shqipërisë dhe besoj se duhet t'i jetësojmë edhe në Kosovë.

Artan, fjala për ty!

ARTON Demhasaj Faleminderit Albulenë! Faleminderit të gjithëve që jeni shprehur të gatshëm të na dëgjoni sot, pikërisht në këtë javën antikorruption që ne e kemi organizuar për herë të parë dhe besoj do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Unë dua ta filloj fjalimin tim pikërisht me perceptimin ose percepcionin dhe dua ta përmbyll me mospajtimin që e kam me lidhur me konfiskim të pasurive.

Dua ta sqaroj këtë perceptimin që kohën e fundit ose muajin e fundit u bë bajagi një pjesë e diskursit politik dhe publik gjithashtu, thuaja se percepcioni është diçka inekzistente, ose percepcioni është diçka që jeton në qiell mirëpo percepcioni është diçka që ne e ndërtojmë duke u bazuar në atë që e shohim, çka e prekim dhe çka e provojmë çdo ditë. Kështu, edhe nëse korrupsioni është percepcion atëherë i bie se është realitet sepse realitet është ajo çfarë shohim ne çdo ditë dhe çka e prekim çdo ditë.

Unë dua të merrem më tepër me fajin që e ka Kuvendi, fajin që e kanë deputetët sa i përket luftës kundërkorrupsionit, jo me prokurori dhe me gjykata pasi që nuk janë të pranishëm këtu, dhe dua të lidhem shumë me pjesën e bamjes së ligjit ose pjesës së nxjerrjes së ligjeve.

Gjithmonë në Kuvend të Kosovës ligjet janë nxjerrë me një procedurë të përsheptuar, për shkak të një standardi ndërkombëtar, për shkak të raportit të progresit ose për shkak të një kërkesë të Bashkimit Evropian apo dikujt tjetër, dhe gjithmonë këto ligje nuk janë bërë si duhet, kanë kaluar shumë shpejt dhe e kemi situatën çfarë e kemi.

Kosova është vendi që e ka shkallën e moszbatueshmërisë dhe mosimplementimit më të lartë të ligjeve në rajon. Pse është kjo? Jo pse i kemi ligjet e mira. Unë asnjëherë nuk mund të ndaj mendimin me asnjë se Kosova i ka ligjet më të mira se sa krejt vendet e rajonit. Dhe sikur Kosova t'i kishte ligjet më të mira se vendet e rajonit, shkalla e implementimit, dhe njëkohësisht edhe suksesi për të luftuar fenomenin kujt i është drejtuar, kishte me qenë të paktën pak më mirë se sa që është sot.

Në praktikë ligjet kozmetike, duken se janë të mira, por absolut nuk përkojnë me realitetin çfarë e ka shoqëria jonë. Dhe derisa ligjet ne i bëjmë, dhe këtu dua ta citoj profesorin Esat Stavileci se gjithmonë ka thënë – nëse ligjin e marrim e përkthejmë ose e bimë prej kahdo, ai nuk do të jetë i suksesshëm. Ligjin duhet përshtatur rrethanave, shoqërisë çfarë e kemi, e jo me marrë një ligj prej kahdo qoftë me prurje se ai ligj ka mund të tregohet i mirë në atë shtet ku ne e marrim. Gjithmonë është mirë me i marrë praktikën e vendeve tjera, me i pa dhe me këqyrë a mund të jenë të vlefshme në shoqërinë tonë a jo, por jo vetëm me marrë ligje të tilla që në praktikë janë të pazbatueshëm.

Tash dua të ndalem te fusha që merret me Agjencinë Kundër Korrupsionit, sidomos në pjesën ligjore, me problemet që ne i kemi identifikuar që sa vite në këtë aspekt, në mënyrë që këto të paktën t'i paraprijnë ndryshimeve ligjore të mundshme që do të bëhen.

Nuk më pëlqen ideja që ka filluar të amendamentohet ose nxjerrët ligj i ri për konflikt të interesit, derisa unë gjithmonë kam kërkuar që të paktën që merren me fushëveprimin e Agjencisë të shkojnë gjithmonë në pako, edhe ligji për Agjencinë, edhe për deklarim, edhe për konflikt, në mënyrë që këto tri ligje të jenë të harmonizuar në mes veti dhe që pastaj në praktikët e mos kemi probleme njëri me tjetrin sepse në të kaluarën kanë pasur probleme. Domethënë ka pasur mospajtueshmëri të këtyre tri ligjeve, sepse në Ligjin për Agjencinë thuhet se Agjencioni kundër korrupsionit është organ i specializuar për të luftuar korrupsionin, e që në praktikë Agjencioni kundër korrupsionit nuk ka fare kompetenca për ta luftuar korrupsionin, por ka vetëm kompetenca për parandalimin. Pra, vetëm një institucion në këtë vend, që është i thirrur me Kodin penal për ta luftuar korrupsionin, është prokuroria e shtetit dhe jo asnjë institucion tjetër.

Dhe krejt këto institucione që i kemi krijuar ne nga Këshilli i presidentit e deri te agjencia vetëm sa e kanë kamufluar dhe e kanë pamundësuar luftimin e korrupsionit sepse edhe përgjegjësia është shpërndarë nëpër institucione të ndryshme.

Po i përmendi disa elemente të deklarimit i pasurisë që duhet të jenë pjesë e ndryshimeve ligjore, ka të bëjë me pasurinë që zyrtarët e kanë jashtë shtetit dhe që nuk e deklarojnë dhe me mundësinë e Agjencisë për ta kontrolluar këtë pasuri që ekziston jashtë shtetit, ose vlera e pasurisë, pra që duhet të jetë një standard i

deklarimit të vlerës së pasurisë e jo t'u lejohet zyrtarëve ta deklarojnë pasurinë ose vlerën e pasurisë ashtu si ata dëshirojnë.

Nga praktika kemi parë se shumë zyrtarë, një pasuri që e ka në një vlerë 200.000 euro, e kanë deklaruar vetëm 50.000 euro, sepse u ka konvnuar për ta ulur vlerën totale të pasurisë. Dhe ka raste të tjera, të kundërt me këtë, që një pasuri që mund të jetë diku 50.000 euro e ka deklaruar 200.000 euro sepse i ka konvnuar t'i rritet vlera totale e pasurisë. Kjo për shkak se ligji nuk e ka paraparë një standard se çfarë do të jetë vlera pasurisë, a do të jetë vlera e tregut apo duhet të jetë një vlerë e caktuar që pastaj të krijohet një standard të të gjithë zyrtarët që pasuria të deklarohet gjithë njëjtë.

Kjo ka prodhuar që një zyrtar i asamblesë komunale të komunës së Prishtinës të deklarojë një pikturë të shkollës fillore me 1 miliardë dhe sot ai zyrtarisht është personi më i pasur në vend, sepse e ka deklaruar pasurinë 1 miliardë. Dhe kjo është pasojë që ligji nuk e ka paraparë këtë dhe për këtë fajin normal e ka mbi të gjitha Kuvendi për shkak se ka lejuar të kalojë në gjëra të tilla pa i vërejtur dhe ndryshuar për dallim që vazhdimisht ne si shoqëri civile kemi kërkuar amendamente, kemi pasur kërkesa dhe në këtë aspekt deri diku kemi pasur mirëkuptim, por për një pjesë tjetër jo.

Po kaloj te Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit. Vazhdimisht ne si organizatë kemi kërkuar që konflikti i interesit duhet të kategorizohet në nivele e jo me qenë vetëm si një kategori totale, sepse nuk mund të vlejë as ndalesat dhe as ... e njëjta për presidentin që është zyrtari më i lartë i shtetit dhe për figura tjera pastaj që vijnë mbrapa dhe nuk janë në hierarki njëjtë.

Pra, duhet të kemi një kategorizim të konfliktit të interesit karshi niveleve dhe pozitive të zyrtarëve të lartë publikë që i kanë.

Gjithashtu ka nevojë këtu të bëhet edhe sqarimi më tepër i veprës penale që është në Kod penal për konflikt të interesit sepse s'i i tillë që është, deri më tani, me sa kam informacione nuk dii se është ngritur ndonjë lëndë duke u bazuar në këtë, ose ekziston vetëm një lëndë që është ngritur duke u bazuar në atë nen për shkak se ka qenë vepra penale shumë e përgjithësuar dhe është shumë problem për ta akuzuar dikend duke u bazuar në atë nen të Kodit penal që e parasheh konfliktin e interesit vepër penale.

Pajtohem se duhet të ketë kufizime sa i përket punësimit në sferën publike, por edhe në sferën private duhet të ketë kufizime me ligj për parandalim të konfliktit të

interesit, e këtë sidomos në edukim dhe arsim, sepse pikërisht kjo na ka sjell në nivelin çfarë jemi sot, çfarë vlerësimi kemi sot për edukimin në Kosovë, sepse profesorët që ne na japin ose na kanë dhënë mësim nëpër universitete tona qoftë publike a private, kanë qenë edhe ministra ose janë ministra, kanë qenë edhe në funksione tjera dhe në asnjërin prej këtyre funksioneve nuk kanë mbërri ta kryejnë si duhet për shkak se edhe fizikisht ka qenë e pamundur për t'i kryer të gjitha këto funksione. Prandaj, një vendosje e tillë për parandalim të konfliktit të interesit mund të jetë shumë pozitive.

Po kaloj tash te Ligji për Agjencinë. Mendoj që duhet të rishikohet por duhet të rishikohet edhe mandati i Agjencisë në përgjithësi dhe duhet të bëhet fillimisht një analizë e punës së Agjencisë prej kur është themeluar e deri më tash, dhe me pa ku ka pasur sukses më shumë Agjencia dhe ku nuk ka pasur, dhe pastaj të fokusohemi e t'i japim funksione dhe kompetenca Agjencisë aty ku Agjencia mund ta luajë rolin më mirë të paktën për parandalim të konfliktit të interesit dhe normal pastaj të vendoset në ligj.

Po kaloj te konfiskimi i pasurive. Unë asnjëherë nuk mund të pajtohem se konfiskimi i pasurive mund të jetë keq, nëse sot vendoset që të kalohet barra e provës te i pandehuri dhe të mos ketë konfiskim të pasurive të paligjshme, e jo të pasurive të fituara me vepër penale dhe që të mos ketë departamente të veçanta brenda prokurorive dhe gjykatave që merren vetëm me konfiskim, ndoshta edhe me luftën kundër korrupsionit. Ne si shoqëri civile kemi pas prurje në këtë komision amendamente për këtë ligj por me keqardhje mundem me thënë se asnjë pikë e asnjë presje prej rekomandimeve tona nuk janë marrë atëherë dhe kjo ka prur pasojën që ai ligj që është miratuar dhe hyrë në fuqi me 1 janar 2013 është ligj total i dështuar dhe nuk është as edhe një rast, të paktën me sa kam unë informacione, që është iniciuar duke u bazuar në atë ligj.

Pra, ai ligj ka kaluar në Kuvend, dhe në atë kohë kur ka kaluar në Kuvend është konsideruar se është ligj i mirë, madhe edhe shumë ligj i mirë edhe prej prokurorëve dhe politikave, por po tregon koha se sa i mirë ka qenë ai ligj, thjeshtë nuk është implementuar fare.

Tash po kaloj te luftimi i korrupsionit dhe parandalimi. Me parandalim mund të luftohet korrupsioni, por mund të luftohet nëse ka vendime të gjykatave mund të parandalohet. E situata çfarë është sot, jo se nuk po parandalohet korrupsioni por thjeshtë po nxitet dhe ata individë që nuk kryejnë vepra penale korruptive po nxiten të kryejnë se po dënohen me kusht ose po dënohen me ndonjë gjobë dhe në

njëfarë mënyre nuk po ka ndonjë goditje të madhe ndaj kryerësve të atyre veprave që pastaj të ketë parandalim edhe te kryerësit tjerë të veprave penale.

Ne sot jemi të vetëdijshëm se disa prej zyrtarëve, jo të gjithë, janë milionerë, dhe i shohim të hyrat e tyre mujore e vjetore çfarë i kanë po njëkohësisht i shohim edhe pasuritë të cilat i kanë deklaruar vet, jo pasuritë që mund t'i kenë pos atyre që i kanë deklaruar, sepse mund të kenë edhe pasuri tjera, dhe është një mospërputhje shumë e madhe në mes të hyrave që ata i kanë e realizojnë dhe pasurive që i kanë. Sikur të kishin punuar 80 vjet ata zyrtarë, me atë rrogë çfarë e kanë është e pamundshme të mbërrijnë nivelin e pasurisë që e kanë. Dhe ne shumë shpejt si organizatë do ta publikojmë një raport dhe gjithashtu një data-bazë interaktive publike për të parë ngritjen e pasurive zyrtare në ndër vite, të paktën prej 2010 deri 2016 kur kanë qenë formularët publikë por për më parë normal se s'kemi mundësi.

Ka raste kur zyrtari ka deklaruar pasuri diku deri 700.000 euro dhe vetë përfitimin e ka deklaruar në vitin 1999 ose 2000. Qysh ka mundësi një zyrtar me fitua pasuri brenda një viti 700.000 euro.

Të gjitha këto dot ë jenë publike shumë shpejt dhe do t'i shihni me emra dhe atëherë të shohim se qysh do të rregullohet kjo punë.

Po ndalem edhe pak tek parashkrimi. Unë personalisht kisha pasur qejf që parashkrimi i lëndëve të korrupsionit ose të rritet, të rritet në dallim me veprat tjera penale dhe s'kisha pasur problem edhe nëse ishte hequr krejt, për shkak se veprat penale kundër korrupsionit deri sa mund për vrasjen e rëndë, deri sa mundet për vepra penale kundër luftës, pse s'mundet edhe për vepra penale kundër korrupsionit. Nuk është asnjë kundërshti. Dikush mund të thotë është në kundërshtim me të drejtat e njeriut ose me Konventën Evropiane për të drejta të njeriut, njëjtë qysh kanë thënë edhe për konfiskimin e pasurive të paligjshme, mirëpo vendimet e gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut kanë qenë që në momentin kur interesi i përgjithshëm i një shoqërie, i një shteti është për atë çështje, dhe drejtat e njeriut bien poshtë. Edhe me këtë rast nëse interesi i shoqërisë sonë është me parandaluar parashkrimin e veprave penale kundër korrupsionit për shkak se po parashkruhen me të madhe, unë kam të dhëna që 78 lëndë kundër korrupsionit janë parashkruar, atëherë mund të tejkalohet e drejta e njeriut dhe nuk është kurrëgjë në kundërshtim me Konventën për të Drejtat e Njeriut.

Dua me nda me ju një shembull, sa i përket konfiskimit të pasurive dhe duke u bazuar në atë se Republika e Shqipërisë e ka dhe ka një ligj që është shumë i zbatueshëm dhe i suksesshëm në aspektin e konfiskimit të pasurive dhe me lidh me

Kosovën sikur ai rast t'ishte paraqitur në Kosovë çka kishte bërë Kosova në këtë rast.

Një shtetase shqiptare ka qenë e martuar me një belg dhe ai belgu, në Belgjikë është marrë me veprimtari kriminale, i ka fituar diku 800.000 euro me veprimtari kriminale, me drogë e çkado, dhe krejt atë pasuri e ka kaluar në llogarinë e bashkëshortes së tij në Tiranë – 800.000 euro. Dhe, prokuroria në Tiranë është ra në dijeni të këtyre pareve dhe menjëherë e ka ftuar në llogari atë personin. Dhe ajo nuk ka qenë në gjendje të argumentojë se atë pasuri e ka të ligjshme për shkak se ka qenë person i pa punë, nuk ka pasur biznes dhe, si mundesh t'i të argumentosh se i ke 800.000 euro në llogari nëse ti nuk ke punë dhe nuk ke biznes. Dhe komplet ajo shumë është konfiskuar duke u bazuar pikërisht në Ligjin për konfiskim të pasurive të paligjshme që e ka Shqipëria.

Sikur ky rast t'kishte qenë në Kosovë, duke u bazuarën Kodin penal ose edhe në Ligjin për kompetencat e zgjeruara, ato para nuk mund të konfiskohen, sepse s'mundesh me e lidh me asnjë vepër penale që është kryer brenda territorit të Kosovës e që t'i mund ta akuzosh.

Do të thotë, kjo është nevoja që thjeshtë duhet të kemi edhe ne ligj për konfiskim të pasurive. Forma, retroaktiviteti dhe të gjitha këto mund të jenë të diskutueshme të paktën për kohën që jemi, por pse është nevojë, mendoj se është nevojë dhe konsideroj se duhet të jetë. Faleminderit shumë!

KRYETARJA: Faleminderit shumë Artan! Cili e do fjalën tash? Urdhëroni!

Artan CANHASI: Faleminderit shumë kryetare!

Faleminderit të nderuar deputetë që e keni ndarë këtë kohë me ne. Është kënaqësi për ne që jemi bashkë me organizatat të shoqërisë civile, bashkë me drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion dhe bashkë me Ambasadën Amerikane, në këtë anë të tavolinës, sepse po synojmë që bashkë ta ndreqim dhe kjo është motoja jonë që e kemi filluar këto ditë.

(Ndërhyrje)

Shpresoj se të gjithë bashkë e ndreqim dhe sidomos është kënaqësi që jam këtu me deputetë dhe zakonisht jemi ata që e monitorojmë praktikisht Kuvendin e Kosovës dhe është kënaqësi që jam me ju.

Pika e parë që desha ta përmendi është se ju jeni në terren. Një problem që u përmend prej kolegëve të mi ishte diskutimi për perceptcionin apo realitetin. Sidomos kjo vlen për deputetët që vijnë nga pozita dhe faktikisht është shumë mirë që ju t'u tregoni edhe këtyre liderëve që i kemi në Qeveri se a është perceptcion apo realitet ky korrupsioni që e ndjejnë njerëzit për shkak se ju jeni në terren më së shumti, ju jeni ata që kërkonin vota edhe për herën tjetër.

(Ndërhyrje)

Po ndoshta këtu është gabimi apo keqkomunikimi. Një prej përkrahjeve më të mëdha që kanë bërë ndoshta Shtetet e Bashkuara të Amerikës është përkrahja që do ta ofrojnë përmes Fondit për milenium Chench korporeishen. Po flasim për 350.000.000 dollarë të cilat priten të humben shumë shpejt pikërisht për shkak të mungesës së luftimit të korrupsionit. Kontrolli i korrupsionit është një nga pikat kryesore dhe kyçe dhe atëherë do të jetë faji i Qeverisë sonë, i deputetëve të pozitës, ndoshta edhe i yni si shoqëri civile që s'e kemi ngritur zërin edhe më shumë për këtë humbje, por përfundimisht do të humbë Kosova 350.000.000 dollarë për shkak të mosluftimit të korrupsionit dhe kjo nuk është perceptim por ky është një realitet që duhet ta marrin parasysh deputetët dhe Qeveria.

Ndoshta ia ndërruam pak stilin dëgjimit publik, sepse ishte një dëgjim për Agjencinë mirëpo nëse më lejoni, tri gjëra do t'i kërkoja nga deputetët. Do të kërkoja së pari, kur të vjen ligji për konflikt interesi tek ju na konsultoni ju lutem. Jemi duke punuar me Qeverinë që ta bëjmë një ligj të mirë, jemi duke u munduar ta bëjmë sa më të mirë dhe nuk e di çfarë del nga aty, por shpresoj se do të dalë një ligj i mirë dhe do ta kemi një draft të mirë dhe synojmë ta përmirësojmë tutje edhe më shumë.

E dyta që dëshiroj nga deputetët, është që emërimet e personave në pozitat e pavarura, sidomos tek bordet të keni kujdes të zgjedhni sa më shumë njerëz profesionalë për shkak se pastaj mozgjedhja e tillë po ka pasoja në secilën fushë që po rregullojnë këta rregullatorët, bordet apo agjencitë të pavarura, sidomos ky komision me kompetencat që ka për emërimin në këshillat gjyqësorë prokuroria që ka pasur të paktën deri vonë dhe sidomos për pjesën e buxhetit është shumë e rëndësishme të aktivizohet edhe më tutje.

Dhe e fundit, ka të bëjë me fragmentimin dhe mbivendosjen e mekanizmave të ndryshëm që luftojnë korrupsionin. Prandaj, ju jeni Parlamenti, ju jeni ata dhe sidomos ky komision që i bën ligjet dhe ju lutem keni kujdes që këto mbivendosje të largohen. Kemi situata të ndryshme sikurse në gjyqësor, por aty ju nuk keni edhe

aq hapësirë që të intervenoni, mirëpo kemi pjesën e ekzekutivit tek policia, tek agjencia ku ka mbivendosje të shumta dhe në këtë mënyrë të kërkon llogari se pse disa hapësira mbeten të lira dhe disa pjesë tjera janë të mbivendosura dhe nuk e din kush e ka kompetencën për ta zgjidhur atë problem.

Edhe një herë, shumë faleminderit! Shpresoj se bashkë e ndreqim edhe në ditët në vijim dhe jo vetëm për këtë javë, por gjatë gjithë tërë kohës.

KRYETARJA: Bashkë është e mundshme! Urdhëroni!

Visar Suta : Nëse më lejohej për dy-tri fjalë! Pasi pjesë e këtij diskutimi është edhe udhëheqësi i Agjencisë Antikorrupsion dhe ashtu siç u përmend edhe nga zotëri Canhasi, kur flasim për mbivendosjen e institucioneve në luftën kundër korrupsionit ju si deputetë duhet të keni vullnetin e mjaftueshëm politik sa i përket mbështetjes së institucioneve të cilat janë përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit.

Nëse marrim e bëjmë krahasime në mes Agjencisë Antikorrupsion, për shembull, dhe Prokurorisë së shtetit, në vazhdimësi ne si KDI dhe duke përfshirë edhe shoqatat tjera të shoqërisë civile kemi vërejtur se ka fajësim të vazhdueshëm. Pra, nëse shkojmë te zyret e Prokurorisë së Shtetit ata gjejnë fajet tek Agjencia Antikorrupsion dhe e kundërta.

Roli juaj është që ta hidhni apo ta ngarkoni një prej institucioneve më shumë se të tjerat, shembull, me mbështetjen financiare. Dhe, nëse Kuvendi i Kosovës koncentrohet në ngritjen e kapaciteteve financiare, shembull, të sistemit të drejtësisë, pra me dyfishimin e buxhetit, dhe kjo është vetëm ide e nuk do të thotë që të përfillet, por nëse ne ia gjuajmë barrën një institucioni atëherë më lehtë e kemi për ta fajësuar atë në qoftë se ai institucion nuk e bën punën ashtu siç pritet nga ne.

Prandaj, ju në këtë drejtim e keni përgjegjësinë që të jeni sa më proaktivë, t'i mbani sa më përgjegjëse këto institucione të cilat e luftojnë korrupsionin, dhe mund të ndodhë edhe e kundërta, pra nëse Agjencia Antikorrupsion kërkon një mbështetje më të madhe, duke ditur se Agjencia ka një synim, ka fokusin kryesor në luftë kundër korrupsionit, atëherë pse ne të mos i japim....(përkrahje).

Në të kaluarën kemi vërejtur se Agjencia Antikorrupsion ka mungesë të kapaciteteve financiare dhe njerëzore dhe për atë arsye është shumë me rëndësi që të përcaktohen prioritetet nga ky Kuvend në mënyrë që ne, si shoqëri civile, ta

kemi më lehtë identifikimin e aktorit kryesor që duhet të marrë flamurtarin në luftë kundër korrupsionit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Visar e pate fjalën për dyfishim të buxhetit të Agjencionit kundër Korrupsionit, apo të sistemit të drejtësisë?

Artan CANHASI Në përgjithësi thashë mbi vendosjen institucionale prej fillimit, dhe për dyfishim të buxhetit.

KRYETARJA: Po, pajtohem plotësisht. Vetëm se, as 2% edhe në buxhetin aktual, drafti nuk ka ndryshim prej vitit të kaluar. Do të thotë as 2% e totalit buxhetor ndahet për sistemin e drejtësisë dhe ka mungesë të prokurorëve e po ashtu edhe mungesë të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.

Zoti Aliu e kërkoi fjalën?

Agim ALIU... Po, faleminderit! Zonja kryetare, edhe unë u ndjeva mirë për pjesën e debatit që patëm, por vërtet mendoj se duhet të bashkohemi rreth një konstatimi, sepse thamë gjërat t'i konstatojmë mirë. Duhet të gjithë të bëhemi bashkë. Nuk mjafton, sikur që e thashë edhe në pjesën e parë të diskutimit, nuk mjafton njëra palë. Nuk mjafton madje as në aspektin e heqjes së ndikimit, se ne po flasim për ndikim në gjykata.

Ne të gjithë e dimë faktin që gjykatat nuk janë të ndikuara vetëm nga pozita, gjykatat janë të ndikuara nga të gjitha palët, prandaj duhet bërë bashkë të gjithë që t'i bëjmë punët mbarë dhe mirë.

Duhet të hiqemi edhe nga komplekset. Ne po i kemi disa gjëra me një lloj kompleksi dhe pastaj ajo po na i humbë ngapak komplet çështjen për të cilën ne po adresohemi sot.

Nuk duhet të jemi ne vazhdimisht, në kuptimin e termave, t'i lëmë këtij ligji këtë emër apo këtë emër, nëse përmbajtja na mbetet anash.

Unë e mbaj në mend, po edhe ju sigurisht kohën kur kemi bërë një luftë kompetencash për rregullore të ndryshme të sistemit të UNMIK-ut. Asnjëherë nuk kam parë se është konstatuar një gjendje sa janë ushtruar ato kompetenca. Është në natyrën e institucioneve dhe njerëzve që të luftohet për më shumë përgjegjësi dhe kompetenca në mënyrë që sfidat – problemet të bëhen të materializueshme, në kuptimin e realizimit.

Mirëpo, ne nuk i kemi implementuar dhe nuk i kemi zbatuar as ato kompetenca që i kemi pasur. Prandaj, t'i zbatojmë ato që i kemi, me ligjet që i kemi dhe nëse diçka na mungon ta plotësojmë edhe atë që mungon, por kjo që është situatë e sotit, nuk është pengesë për luftën që duhet ta bëjmë.

Ne do të kemi parasysh edhe një fakt. Gjyqtarët janë në mes ndikimit por edhe në mes frikës. Por, mbi të gjitha, vërtet duhet ta ushtrojnë funksionin si duhet, për faktin se nuk është që ka munguar vullneti politik të paktën në këtë komision. Kush e ka përcjell punën e Komisionit... nuk po them që s'kemi pasur edhe polarizime politike. Kemi pasur në çështje të caktuara, por mbi të gjitha e ka dominuar debatin gjatë kësaj kohe në komision pikërisht kjo temë dhe pikërisht ndryshimi i atyre projektligjeve dhe çështjeve të tjera që kanë kaluar nëpër këtë komision. Domethënë ka pasur pozitë e opozitë këtu në këtë komision vullnet për t'u bërë ajo që është kërkesë qytetare, kërkesë e shoqërisë në përgjithësi. Mirëpo, ne jemi duke u marrë me një konstatim se atje ku duhet të funksionojë nuk është kah funksionon.

Ne konstatuam një gjendje se organizatat e pavarura nuk janë kah i zbatojnë ato kërkesa të cilat ato i kanë pasur. Dhe çfarë kërkohet tash nga ne? Për atë arsye po e bëj këtë komparacion kur ishte një kohë e UNMIK-ut dhe kërkohesh kompetenca ende pa u zbatuar. Dhe tash na u kërkuan nga KGJK, nga KPK, nga institucionet tjera të pavarura kompetenca dhe ne i dhamë. Na thanë ta bëjmë depolitizimin, e bëmë. Ku janë ata me punën e tyre?

Prandaj, mendoj se duhet adresim edhe i qartë por vërtet edhe kërkesë që të jetë tamam si duhet. Kjo është kah çalon. Dhe nuk është e drejtë, po e them edhe një herë që të ketë target vetëm një grupacion i caktuar, qoftë ai politik apo jo politik, sepse kjo është temë që i ka prek të gjitha grupacionet politike.

Mirëpo ne nuk mund të bëjmë apo të fusim zemra të luanëve nën lëkura të lepujve. Gjyqtarët duhet ta bëjnë punën e tyre dhe sigurisht se duhet edhe siguria për ta, por janë hapa që ne duhet t'i bëjmë, por ata duhet edhe të marrin guximin sepse ka pasur edhe kërkesa të tjera të plotësuara nga ta, kanë qenë edhe çështjet e pagave, që nuk po them se janë të mjaftueshme, por nëse duhet do e bëjmë.

U kërkua këtu të shtohet buxhet. Po në buxhetin aktual është një shtesë, jo aq sa duhet, por është një shtesë në kuadër të sistemit të drejtësisë, kemi suport edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë përmes fondeve të caktuara.

Edhe në seancën e fundit plenare, ne që i kemi miratuar fondet e IPA-s shumica janë pikërisht për të mbështetur sistemin e drejtësisë. Më nuk është se është problemi krejt te buxhetet. Është problemi te vullneti i përgjithshëm politik, por është mbi të gjitha edhe te guximi për t'u ballafaquar me këtë sfidë që e kemi. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit zotii Aliu. Urdhëroni zoti Pal!

PAL LEKAJ: Sa i përket kësaj që dëgjova nga shoqëria civile, unë mendoj që, është e vërtetë se edhe dhënia e kompetencave duhet përcjell me llogaridhënie dhe kjo nuk ka kuptim nëse mendojmë ndryshe.

Mirëpo, çdoherë ka pasur tendencë që të zbehet roli i Parlamentit të Kosovës. Kur e them këtë, mendoj se edhe sot këtu, shembull mekanizmat që i ka Parlamenti i Kosovës janë komisionet përkatëse që i monitorojnë fushat e caktuara. Sot, për shembull, ministrja e Drejtësisë e injoron një ftesë me kohë që ia ka bërë Komisioni dhe i del diçka shumë mbi komisionin dhe që mendoj se është e pakuptimtë nuk kishte me ndodhur në asnjë vend në botë, nëse thirret një ministër nga komisioni dhe nga të zgjedhurit e popullit.

Çfarëdo që të jemi, populli na ka votuar. Dhe unë jam krenar, nëse 10 mijë veta më kanë votuar, a më kanë votuar për të korruptuar, a më kanë votuar për njeri kriminel apo tjetër, por e kam një votë të qytetarëve që kurrkush nuk mund ta kontestojë.

Prandaj, në këtë drejtim mendoj që sa më shumë të jetë roli parlamentar nën mbikëqyrej, nën monitorim dhe kërkesë në llogaridhënie, kujtdoqoftë ai. Mendoj se këtu kemi një funksion funksional dhe ka për të dhënë llogari para atyre që janë të zgjedhur. Tek ne s'kanë dhënë. Ne vetë i zgjedhim dhe më kush nuk përgjigjet as para komisionit, as para atyre njerëzve që janë të zgjedhurit e popullit dhe këtu mendoj se çalon.

I vetmi është parlamenti, sido e kudo në botë, e ka fushën e monitorimit i të gjithë asaj kupolës kudo që jenë, në çfarëdo roli, por jo të përzierjes në kompetenca që i ka miratuar vetë parlamenti me ligje të fushave të caktuara. Dhe këtu po i dallojmë dhe mendoj që deri sa ne nuk e kuptojmë këtë shumë vështirë do të kemi një luftë tamam kundër korrupsionit, dhe deri sa ne njeriun tonë e injorojmë, mos pritni se kemi me pasur ndonjë sistem të mirëfilltë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit zoti Lekaj! Nuk është vetëm problemi se nuk ballafaqohet me deputetët në komisionet parlamentare. Qasje të njëjtë po ka edhe te pyetjet parlamentare. Do të thotë unë nuk e kuptoj këtë qasje për faktin e përgjegjësisë që e ka Qeveria karshi Kuvendit. Nuk po zbulojmë asgjë. Thjeshtë po kërkojmë përgjegjësi nga Qeveria si deputetë të Kuvendit të Republikës që jemi.

Dhe në qoftë se nuk angazhohemi bashkërisht, atëherë natyrisht se rezultatet nuk mund të priten. Prandaj, të gjitha këto që u diskutuan këtu do të ishte tepër më mirë dhe më e vlefshme sikur ministrja e Drejtësisë të dëgjonte shqetësimet që i kemi edhe si deputetë po edhe si shoqëri civile dhe Agjencion Kundër Korrupsionit.

Unë do të doja të ju falënderoj sinqerisht për të gjitha sugjerimet e kritikën të cilat i keni parashtruar para anëtarëve të Komisionit për Legjislacion dhe po ashtu ju falënderoj edhe për gjithë këtë organizim edhe të Javës kundër korrupsionit. Në veçanti, e falënderoj edhe Ambasadën Amerikane.

Ne do të mundohemi që bashkë me administratën të bëjmë disa rekomandime apo propozime që kanë dalë nga ky dëgjim publik dhe të mos mbetet ky dëgjim vetëm si deklaratë publike para mediave. Po ashtu i falënderoj edhe mediat që kanë qëndruar deri tash në Komision për Legjislacion për faktin se po të mos ishin, natyrisht se debati do të ishte i kotë.

Pra, edhe një herë ju falënderoj. Shihemi në takime tjera të radhës!